

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- si të bëhemi një qytet, lagje, fshat, komunitet apo ishull i Tranzicionit

Nga Ben Brangwyn dhe Rob Hopkins

Përktheu: Rita Strakosha

Versioni: 26

Statusi: FINAL

Shënim: ky dokument përditësohet rregullisht. Versioni aktual gjendet në adresën:
"<http://transitiontowns.org/TransitionNetwork/TransitionNetwork#primer>".

Përmbajtja:

Hyrje	3
Përse janë të nevojshme iniciativat e tranzicionit?.....	4
Rreth pikut të naftës.....	4
AKTIVIZIMI: tabloja e gjerë – iniciativat në nivel botëror, kombëtar dhe vendor	8
Modeli i tranzicionit, çfarë është?.....	9
Kinsale 2021 – Plani i aksionit për pakësimin e energjisë.....	11
Totnes, qyteti i tranzicionit.....	11
Iniciativa të tjera të tranzicionit	13
Krijimi i iniciativës suaj të tranzicionit – kriteret.....	16
Organizimi i lëvizjes së tranzicionit– tipa të ndryshëm organizimi	18

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Krijimi i iniciativës së tranzicionit-organet drejtuese dhe statuti	20
7 probleme që mund të hasni në iniciativën tuaj	21
12 hapat e tranzicionit.....	23
Plani i aksionit për pakësimin e energjisë (PAPE).....	28
Tranzicioni në një kontekst më të gjerë	30
Probleme të drejtimit dhe organizimit.....	32
Roli i qeverisë lokale.....	33
Përfshirja e bizneseve.....	36
Filma mbi pikun e naftës dhe ndryshimin e klimës.....	38
Rrjeti i Tranzicionit	47
Konkluzione.....	48
Lexime të tjera	48
Detaje kontakti:.....	49

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit



Ajzbergu Upsala, Argjentinë,

Ish-më i madhi në Amerikën e Jugut, më 1928 dhe 2004

Hyrje

Disa komunitete pioniere në Britaninë e Bashkuar, Irlandë dhe më tej, në përgjigje të sfidave të njëkohshme të pikut të naftës dhe ndryshimit të klimës, kanë ndërmarrë një iniciativë gjithëpërfshirëse për të pakësuar konsumin e naftës dhe rritur aftësinë e tyre për të përballuar ndryshimet rrejtësore që do të sjellë piku i naftës.

Ky dokument ka një përmbledhje të këtyre iniciativave.

Ky dokument është përgatitur nga Rrjeti i Tranzicionit, një organizatë jo fitimprurëse e krijuar së fundmi mbi themelet e hedhura nga iniciativat e tranzicionit në Kinsale, Totnes dhe komunitete të tjera.

Misioni ynë është të frymëzojmë, informojmë, mbështesim, ndërlihim dhe trajnojmë komunitetet që kërkojnë të përfshihen në lëvizjen e tranzicionit.

Jemi duke organizuar një sërë materialesh, kursesh trajnimi, aktiviteteve, mjetesh dhe teknikash, ndihme financiare dhe mbështetjeje për të ndihmuar këto komunitete.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Jemi vetëm në fillimet tona dhe kemi shumë përpara. Por, e kuptojmë sa e vështirë do të jetë dhe po bëjmë ç'është e mundur. Mbështetja financiare që po na jep së fundmi Fondacioni Tudor po na ndihmon së tepërmi.

Përse janë të nevojshme iniciativat e tranzicionit?

Dy problemet më të mëdha që përball njerëzimi në fillim të shekullit të 21-të janë ndryshimi i klimës dhe piku i naftës. Për ndryshimin e klimës ka mjaft informacione dhe po flitet shpesh në media. Por pak po flitet për pikun e naftës.

Piku i naftës, me të cilin do të fillojë periudha e skarcitetit të naftës, mund të krijojë destabilitet ekonomik dhe social dhe të pengojë përballimin e ndryshimi të klimës.

Iniciativat e tranzicionit në Britaninë e Madhe dhe në botë kanë qëllim të angazhojnë njerëzit dhe komunitetet për të ndërmarrë veprimet radikale të nevojshme për zbutjen e efekteve negative të pikut të naftës dhe ndryshimit të klimës.

Përveç kësaj, përpjekjet për ri-lokalizim kanë qëllim që jeta të bëhet më kuptimplotë, më pak e vetmuar dhe më e barabartë.

Rreth pikut të naftës

Ndoshta nuk keni lexuar rreth pikut të naftës në media. Mos u gënjeni. Edhe për ndryshimin e klimës pak flitej më përpara.

Që nafta ka arritur pikun e prodhimit të saj nuk do të thotë se ajo do të mbarojë-nafta nuk do të mbarojë asnjëherë. Nën tokë do të mbetet naftë, sepse do të jetë e vështirë gjetja ose nxjerrja e saj. Kini parasysh një fakt të cilin ekonomistët e nënvleftësojnë- në momentin që për të nxjerrë një barrele naftë nga toka do të shpenzohet po aq energji saç ka barrela e gjetur, eksplorimi, shpimet për naftë dhe nxjerrja e saj nga toka do të ndalen.

Piku i naftës do të thotë se nuk do të ketë më naftë me bollëk, me çmim të lirë, se konsumi gjithmonë e më i madh e naftës ka arritur kulmin dhe pakësimi është i pashmangshëm.

Mënyra aktuale e jetesës është shumë e varur nga konsumi i tepruar i naftës.

Nga fillimi i viteve 1900, nafta e bollshme mundësoi zhvillimin e shpejtë të shoqërisë dhe industrive që shfrytëzonin burimet fosile të energjisë. Që nga ajo kohë, çdo vit është konsumuar sasi në rritje e naftës (duke përjashtuar dy reçesionet ekonomike të viteve 70 të shkaktuara nga kriza në Lindjen e Mesme). Dhe çdo vit shoqëria u bë më komplekse, më e mekanizuar, më globale, me nivele konsumi energjie më të mëdha.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Problemet fillojnë kur rreth gjysma e naftës së nxjerrshme është konsumuar. Këtu nafta fillon të shtrenjtohet (si në kuptimin ekonomik ashtu dhe në atë energjistik), nxirret më me vështirësi dhe ka cilësi më të dobët. Për herë të parë në histori nuk do të jemi në gjendje të rrisim sasinë e naftës së nxjerrë, rafinuar dhe tregëtuar. Oferta e naftës nuk rritet më dhe fillon të bjerë, me pasoja të jashtëzakonshme për shoqëritë e industrializuara.

Shumë pak njerëz po i kushtojnë vëmendje këtij fenomeni, dhe është e lehtë të kuptohet përse.

Analogjia e gabuar me serbatorin e naftës

Përvoja jonë me mbarimin e naftës së makinës mund të na krijojë një përshtypje të gabuar mbi atë si do të mbarojë nafta në ekonomi.



Makina juaj ecën pa difekte derisa të kenë mbetur vetëm gramët e fundit të naftës-kur serbatori është rreth 97% bosh. Vetëm atëherë e jep efektin boshatisja e serbatorit. Makina fillon të dridhet, të kërcasë, menjëherë kuptoni se duhet të merrni masa përndryshe makina do të ndalet papritur. Mund të injorojmë matësin e serbatorit derisa serbatori pothuaj boshatiset.

Por mënyra sesi mbarimi i naftës do të ndikojë në ekonominë botërore është krejt ndryshe. Ndikimi do të ndihet jo kur të afrohet mbarimi i naftës, por kur gjysma e naftës të jetë konsumuar. Ja përse...

I rikthehemi fenomenit të pikut të naftës

Mbarimi i naftës do të ndodhë vonë, nuk do të ndodhë së afërmi. Por çfarë është duke ndodhur është se nafta po gjindet gjithmonë e më me vështirësi dhe po shtrenjtohet. Kjo do të thotë se do të fillojë pakësimi i energjisë së konsumueshme-një periudhë e gjatë, gjatë së cilës, çdo vit do të pakësohet nafta e nevojshme për furnizimin e jetës sonë të industrializuar.

Faktet dhe konsequencat e tyre janë këto:

- nga të gjitha burimet energjitike fosile, nafta është më e pasur me energji dhe e më lehtë për tu transportuar.
- zhvillimi i ekonomive moderne është bërë i mundur nga konsumimi gjithmonë në rritje i naftës.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- elementët kryesorë të shoqërive të industrializuara –transporti, fabrikimi, prodhimi i ushqimeve, ngrohja e banesave, ndërtimi-janë plotësisht të varura nga nafta.

- ka shumë rëndësi të kuptohet si shterojnë nga nafta fushat naftëmbajtëse. Ka një karakteristikë si për fushat e veçanta naftëmbajtëse, ashtu dhe për rajone të tëra, shtete dhe madje për tokën: gjysma e parë e naftës nxirret me lehtësi dhe ka cilësi të lartë. Pasi është nxjerrë rreth gjysma e naftës, nxjerrja e gjysmës tjetër bëhet me kosto më të lartë, më e ngadaltë, kërkon më shumë energji dhe cilësia e naftës është më e dobët.

- Nafta, e cila këto 150 vjet është nxjerrë në sasi gjithmonë e më të mëdha, do të kulmojë. Çdo vit pas kulmimit do të ketë sasi gjithmonë e më të pakta të naftës, si dhe një rrezik të rritur për ndërprerje në furnizimin e saj.

- një numër gjithmonë e më i madh i ekspertëve të pavarur të naftës dhe i gjeologëve të naftës kanë llogaritur se kulmimi do të ndodhe në vitet 2006-2012 (konfirmimi i kulmimit mund të bëhet disa vjet pas ngjarjes).


- përparimet teknologjike në nxjerrjen e naftës dhe eksplorimet do të kenë një efekt të vogël në shpejtësinë e shterimit të naftës. Psh. kur 48 shtetet e SHBA-së (pa përfshirë Alaskën, Havain etj.) arritën pikun e prodhimit të naftës në vitin 1972, shpejtësia e pakësimit të naftës në dekadat në vijim ishte e madhe, pavarësisht përmirësimeve të mëdha teknologjike.

Kjo ka implikime të jashtëzakonshme për shoqëritë moderne.

Për të kuptuar shkallën e ndikimit që kjo do të ketë në botën e industrializuar, ju citojmë paragrafin hyrës të një raporti të përgatitur nga analistë të naftës dhe menaxhimit të riskut, në vitin 2005, për qeverinë e SHBA-së:

"Kulmimi i prodhimit të naftës paraqet për SHBA-në dhe botën një problem të paprecedent. Me afrimin e pikut, çmimet e naftës dhe nën-produkteve të saj do të rriten, do të bëhen të paqëndrueshme, dhe nëse nuk merren masa në kohë, kostot ekonomike, sociale dhe politike do të jenë të jashtëzakonshme. Mundësi zbutjeje të impaktit ka si në anën e ofertës, ashtu dhe në anën e kërkesës, por për të pasur një impakt të ndjeshëm përshtatja duhet të fillojë të paktën një dekadë përpara kulmimit të naftës."

Kulmimi i prodhimit botëror të naftës: pasojat, zbutja e tyre dhe menaxhimi i riskut. Robert



Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

L. Hirsch, SAIC

Ky raportim doli në dritë pasi ishte harruar për pothuajse një vit nga administrata e SHBA-së. Një këqyrje e implikimeve të raportit tregojnë pse qeveria nuk ishte e interesuar ta përhapte atë në publik. Pavarësisht neglizhimit nga qeveritë, agjensitë qeveritare, kompanitë e naftës, se ndodhemi përpara një problemi, si Chevron ashtu dhe Total kanë pranuar se jemi afër fundit të bollëkut të naftës.

Jeremy Gilbert, ish krye-inxhinjer naftë i BP-së, në Maj 2007 tha:

“Mendoj se piku do të arrihet përpara vitit 2015 dhe nafta do të pakësohet me 4-8% në vit“

Disa senatorë amerikanë, kryesisht republikani Roscoe Bartlett, po e ngrejnë problemin në dhomën e senatorëve.



Në Zelandën e Re, një ndër drejtuesit e partisë së gjelbër, Jeanette Fitzsimmons, po përpiqet të ndërgjegjësojë mbi rreziqet e pikut të naftës. Në vitin 2006, Helen Clark, kryeministrja e Zelandës së Re, tha:

“...çmimi i naftës është tepër i lartë sepse ka mundësi të jemi afër pikut të naftës, në mos piku i naftës ka mbërritur.“

Në Australi, deputeti Andrew McNamara drejton komisionin parlamentar të Queenslandit për naftën. Tani ai është ministër i ndryshimit të klimës dhe i zhvillimit të qëndrueshëm në Queensland. Përpara publikimit të raportimit të tij të porositur nga qeveria “Ndikimi i çmimeve të naftës në ekonominë e Queenslandit”, ai flet për rëndësinë e rilokalizimit për shkak të shterimit të naftës:

"Është mëse e qartë se iniciativat vendore të komuniteteve do të jenë më të rëndësishmet. Qeveritë patjetër do të luajnë rolin e tyre duke ndihmuar dhe inkurajuar iniciativat vendore për furnizimin lokal me ushqime, burime energjie, ujë, vende pune dhe artikuj konsumi. Ka qënë një nga pretendimet e mia të fjalimit të parë që kam bërë rreth kësaj çështjeje në shkurt 2005 se do të shohim një rilokalizim të jetesës, e cila do të na kujtojë jo shekullin e kaluar, por shekullin përpara atij. Kjo nuk është diçka e keqe. Përshtatja më e lehtë ndaj pikut të naftës është konsumi lokal, prodhimi lokal dhe shpërndarja lokale. Kjo do të ketë dhe anën pozitive që do të ingranohemi më mirë në komunitetet tona. Rilokalizimi do të sjellë avantazhe të cilat i pres me kërshtëri."

Andrew McNamara, Ministri i Ndryshimit të Klimës dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Queensland-it

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Por, me disa përjashtime të pakta, udhëheqësit e shteteve nuk kanë marrë masa të rëndësishme për adresimin e këtyre problemeve. Atëhere, nëse liderët politikë nuk po merren me problemin, kush do të merret?

Teknologjia shpesh përmendet si zgjidhja e problemeve nga ndryshimi i klimës dhe piku i naftës.


Por, një këqyrje e kujdesshme e zgjidhjeve teknologjike të ofruara tregon se ato janë të papjekura, kanë pasoja mjedisore të rënda dhe nuk janë shumë realiste. Mund të ngurrojmë të veprojmë dhe të presim për teknologjinë ose qeveritë të zgjidhin problemin. Por duket se po krijohet konsensusi i përgjithshëm se kjo do të ishte e rrezikshme.

U takon komuniteteve lokale të marrin iniciativën të parat.

Duhet të fillojmë TANI ti përshtatemi efekteve të kulmimit të naftës. Lajmi i mirë është se shumë nga masat që duhen marrë për t'ju përshtatur ndryshimit të klimës shërbejnë dhe për mbrojtjen nga piku i naftës, dhe anasjelltas.

AKTIVIZIMI: tabloja e gjerë – iniciativat në nivel botëror, kombëtar dhe vendor

Lëvizja e Tranzicionit vepron mbi parimin “mendo globalisht, vepro lokalisht”. Megjithatë është e natyrshme të mendosh se sa peshë ka veprimi yt kur problemet janë kaq madhore.



Përpara se të mendoni këtë, kujtoni se sa herë që ju veproni, jeni një model për njerëzit e tjerë. Këta frymëzohen prej jush, veprojnë dhe frymëzojnë të tjerë. E kështu me rradhë. Kontributi juaj i vogël shumëfishohet dhe bëhet i rëndësishëm.

Duhet të dini se ka projekte në zbatim të cilat adresojnë pikun e naftës dhe ndryshimin e klimës në një nivel botëror dhe kombëtar. Iniciativat e tranzicionit plotësojnë këto projekte dhe ndihmojnë realizimin e tyre konkret.

Disa nga projektet kryesore:

Në nivel botëror

- marrëveshja ndërkombëtare e propozuar për shterimin e naftës (Protokolli i Shterimit të Naftës) parashikon që shtetet në bashkëpunim me njëri tjetrin të pakësojnë konsumin e naftës. Protokolli shërben

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

si një udhëzues si për vendet prodhuese ashtu dhe për ato konsumuese të naftës për pakësimin e konsumit të naftës. Për më shumë informacion lexoni www.oildepletionprotocol.org.

• Tkurrje & konvergencë, një marrëveshje ndërkombëtare e propozuar për pakësimin e emetimeve botërore të karbonit dhe arritjen e niveleve të njëjta të emetimit për frymë të popullsisë në të gjithë botën. Për më shumë lexoni <http://www.climatejustice.org.uk/about/>

Në nivel kombëtar: Sisteme të racionizimit të energjisë duken premtuese. Qeveria britanike duket se po kërkon ta sjellë në vëmendje këtë zgjidhje shumë praktike. Për më shumë lexoni www.teqs.net.

Në nivel vendor: Këtu luajnë një rol të rëndësishëm iniciativat e tranzicionit. Qëllimi i këtyre iniciativave në thelb është ri-lokalizimi i elementëve të nevojshëm për jetesën e komunitetit. Qëllimi është përshtatja e komunitetit ndaj efekteve të kulmimit të naftës si dhe pakësimi drastik i emetimit të dioksidit të karbonit. Kështu, adresohet si problem si piku i naftës ashtu dhe ndryshimi i klimës.

Disa qytete në SHBA si dhe mbi 100 komunitete në të gjithë botën kanë filluar rrugëtimin e tyre drejt ri-lokalizimit. Psh. qyteti Portland në Oregon (me 550,000 banorë) sapo ka publikuar raportin e tij mbi pikun e naftës, për konsultim nga publiku. Paragrafi hyrës i raportit shpjegon shqetësimet e tyre:

"Në vitet e fundit, shumë prova kanë dalë të cilat hedhin hije mbi prezumimin se burimet e naftës dhe gazit natyror do të mbeten të shumta dhe të lira, dhe këto prova sugjerojnë se prodhimi botëror i naftës dhe gazit natyror do të kulmojë së shpejti. Ky fenomen quhet "Piku i Naftës". Roli i rëndësishëm i këtyre produkteve në aktivitetet shoqërore, sociale, ekonomike, gjeopolitike, dhe kërkesa në rritje për to, bën që pasojat e pikut të naftës të jenë të jashtëzakonshme."

Portland ka përfshirë në objektivat e saj strategjinë e Protokollit të Shterimit të Naftës – Portlandi ka si objektiv të pakësojë konsumin e naftës dhe gazit natyror me 2.6 % çdo vit, duke arritur një pakësim prej 25 % deri në vitin 2020.

Në Britaninë e Madhe, një numër në rritje komunitetesh po ndjekin me vëmendje planin i aksionit për pakësimin e energjisë që po zbatohet në Kinsale, Irlandë dhe Totnes, Devon.

Në Britaninë e Madhe ka shumë plane të shkëlqyera të pakësimit të energjisë që po zbatohen nën moton e zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, për të pasur zgjidhje gjithpërfshirëse, duhet të njohim pikun e naftës, ndryshimin e klimës dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Modeli i tranzicionit, çfarë është?

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Modeli i tranzicionit është tërësia e parimeve dhe praktikave që ndihmojnë në realizimin e tranzicionit, dhe që kanë dalë nga praktika.

Më shumë informacion do ju japim më tutje, gjithsesi po ju përshkruajmë, një përvijëzim të modelit.



Ndërgjegjësimi

Baza e modelit të tranzicionit është ndërgjegjësimi për sa vijon:

- Duhet të veprojmë urgjentisht për përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës dhe pikut të naftës
- jeta me më pak energji do të jetë e paevitueshme prandaj më mirë të përgatitemi për këtë sesa të ndodhemi përpara të papriturave
- shoqëria e industrializuar nuk di të përshtatet ndaj rënieve drastike të furnizimit me energji
- duhet të veprojmë së bashku dhe duhet të veprojmë tani
- për sa i përket ekonomisë botërore dhe prirjes konsumeriste të saj: sipas ligjeve të natyrës, rritje të pafundme në një sistem të fundëm (siç është planeti tokë) nuk mund të ketë
- Njerëzimi ka treguar inteligjencë dhe fantazi të madhe në shfrytëzimin gjithmonë e më të madh të energjisë këto 150 vitet e fundit, dhe nuk ka përse të mos tregohemi njëlloj inteligjentë dhe me fantazi pas pikut të naftës
- nëse përgatitemi dhe veprojmë në kohën e duhur, përdorim fantazinë dhe bashkëpunimin për të çliruar gjenialitetin tonë kolektiv, atëherë mund të ndërtojmë një të ardhme që mund të jetë shumë më kuptimplotë, më e mirë, më afër natyrës se jeta që po bëjmë sot

7 "Por"et

Kur ndodhen përpara nevojës për të bërë ndryshime të vështira, njerëzit kanë prirje të krijojnë pengesa emocionale dhe të mos veprojnë. Këtu do të përmendim disa nga arësyetimet tipike negative që kemi hasur.

12 hapat drejt tranzicionit

Këto janë fushat që mendojmë se janë më kritiket për sa i përket iniciativave të tranzicionit. Komunitetet po i praktikojnë hapat e rekomanduar siç e shikojnë të arësyeshme.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Kjo listë e hapave nuk është e detyrueshme, është thjesht një listë e hapave që nga eksperiencia jonë mendojmë se është praktike për tu ndjekur. Me kalimin e kohës, rritjen e përvojës, ato do të ndryshohen.

Rrjeti i Tranzicionit

Roli i Rrjetit të Tranzicionit është të frymëzojë, inkurajojë, mbështesë, ndërlihdë dhe trajnojë komunitetet në përpjekjet e tyre për të kuptuar dhe implementuar modelin e tranzicionit.

Kinsale 2021 – Plani i aksionit për pakësimin e energjisë

Drafti i parë i Planit të Aksionit për Pakësimin e Energjisë, të qytetit Kinsale, u përgatit në vitin 2005. Ai përcakton se si Kinsale, një qytet Irlandez në West Cork, me rreth 7000 banorë, mund të realizojë tranzicionin nga një qytet me konsum të lartë energjie në një qytet me konsum të pakët, në përgjigje kjo të kulmimit të prodhimit të naftës. Ky raport, i përgatitur nga studentët e permakulturës të një kolegji në Kinsale nën mbikëqyrjen e Rob Hopkins, analizon se si Kinsale mund të ecë përpara në këtë të ardhme të vështirë duke planifikuar jetën me më pak energji dhe duke përcaktuar dhe afatet e strategjisë. Ky projekt është ndër të parët në botë. Raporti analizon të gjithë aspektet e jetës në Kinsale, përfshirë ushqimin, energjinë, turizmin, edukimin dhe shëndetin.


Raporti është strukturuar në mënyrë të tillë që të mundësojë komunitetet dhe qytetet e tjera të adoptojnë një projekt të ngjashëm.

Projekti mori çmim nderi nga Forumi Ambientalist Cork në vitin 2005 dhe, çka është më e rëndësishme, u aprovua unanimisht nga këshilli bashkiak i Kinsale në fund të vitit 2005.

Ky është një projekt inovativ i përgatitur nga studentët. Zbatimi i tij konkret, në komunitet, kërkon shumë punë, por si fillim është i mbarë.

12 hapat që do të përshkruajmë në broshurë kanë dalë nga çka kemi mësuar nga Kinsale.

Plani mund të daunlodohet në adresën: <http://transitionculture.org/wp-content/uploads/members/KinsaleEnergyDescentActionPlan.pdf>.




Totnes, qyteti i tranzicionit

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Iniciativa e tranzicionit në Totnes u inicua nga Rob Hopkins. Robi ju përvesh kësaj iniciative pas mbikëqyrjes prej tij të krijimit të planit për pakësimin e energjisë për qytetin Kinsale, Irlandë.

Totnes, Qytet Tranzicioni, është qyteti i parë i tranzicionit në Britaninë e Madhe, dhe objektivi i tij është rilokalizimi, aty ku është e mundur, i gjithë sferave të jetës.

Arësytimi është se një qytet që përdor shumë më pak energji dhe burime, nëse çdo gjë përgatitet me kujdes, mund të bëhet më i begatë, më i këndshëm dhe më pak i brishtë.



Një komunitet që pjesën më të madhe të nevojave të veta i plotëson nga burimet e veta do të jetë shumë më i përgatitur për të përballuar pikun e naftës dhe ndryshimin e klimës sesa komunitetet aktuale të cilat varen tërësisht nga ekonomia botërore për energjinë, transportin, ushqimin dhe strehimin.

Gjatë vitit 2007 do të vazhdojë ideimi i planit të aksionit për pakësimin e energjisë për qytetin Totnes, plan i cili do të ketë dhe afatet e veta të implementimit. Projekti kërkon të jetë gjithëpërfshirës, praktik, tërheqës dhe me fantazi.

Projekti i Totnesit filloi nga fundi i vitit 2005 me një program intensiv ndërgjegjësimi mbi problemet e pikut të naftës dhe ndryshimit të klimës. Pasi komuniteti ishte informuar mirë për këto probleme, projekti u prezantua zyrtarisht në shtator 2006, në ambjentet e bashkisë, përpara 350 të pranishmëve. Nëpërmjet një numri gjithmonë e më të madh prezantimesh, kursesh trajnimi, takimesh, seminaresh, intervistash, dokumentesh, blogjesh dhe pune të vazhdueshme, iniciativa është kuptuar mirë nga banorët e qytetit dhe po përparon.

Mbledhjet, seminarët e zhvilluara deri në qershor 2007:

- 8 transmetime filmi dokumentar
- 7 prezantime nga ekspertë si psh.:
 - Richard Heinberg (www.richardheinberg.com),
 - Aubrey Meyer (Tkurrje & Konvergencë - http://en.wikipedia.org/wiki/Contraction_and_Convergence),
 - David Fleming (www.teqs.net),
 - Mayer Hillman (aktivist dhe publicist mbi ndryshimin e klimës)
 - “Kultivimi i ushqimeve”, panair në hollin Darlington me organizues Chris Skrebowski, Jeremy Leggett, Patrick Holden dhe Vananda Shiva
- 7 evenimente të zhvilluara me deri në 400 pjesëmarrës secila, përfshirë
 - evenimentin prezantues të lëvizjes së tranzicionit në Totnes.
 - Mbledhje në ambjente të hapura me tema mbi ushqimin, energjinë, gjendjen shpirtërore dhe strehimin

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- mbledhje të djelave për këmbimin e farave
- Mbledhje e këshillit vendor në kolegjin Schumaker
- “pronat në tranzicion”, seminar një-ditor për pronarët e vegjël të tokave për te analizuar opsionet e tyre në një ri-lokalizim
- kurse trajnimi –kurse nate 10 javore “Të mësojmë zanate për të qenë të përgatitur”
- seminare: Zbulimi i bizneseve më të ndjeshme ndaj çmimeve të naftës (3 biznese lokale ju bashkuan kësaj iniciative)
- Ngrohja e ujit nëpërmjet paneleve djellore
- Projekte pilot: monedha lokale (paundi Totnes është pranuar nga rreth 20 biznese lokale), tashmë po reklamohet të përdoret në një shkallë më të gjerë pas fillimit të sukseshëm të saj. Në projekt po marrin pjesë 65 biznese dhe janë shtypur 10,000 bankënota.
- Arshivat e historisë: mbledhja e dëshmimeve nga të moshuar që kanë jetuar në kohërat kur konsumohej pak energji
- Totnes, qyteti ku do të mbillen më shumë arra, lajthi dhe gështenja: kanë filluar mbjelljet e para të këtyre pemëve
- Tregime mbi tranzicionin: ndërgjegjësimi i fëmijëve të shkollave për nevojën e një jete me më pak energji
- Këmbimi i kopshteve: ndërmjetësimi midis të moshuarve që e kanë të pamundur të punojnë kopshtet e tyre dhe njerëzve që nuk kanë kopshte por duan ti punojnë.



Programi i aktiviteteve vazhdon me ritëm të tillë përgjatë verë 2007-ës.

Përveç aktiviteteve të mësipërme, ka 10 grupe pune të cilat takohen rregullisht për të gjetur praktika që përdorin më pak energji në këto fusha: energji, shëndet, ushqim, arte, psikologji, qeverisje vendore, ekonomi etj. Ka grupe të tjera të cilat po përmbledhin përvojën e deritanishme për të krijuar planin e tranzicionit për Totnes.

Mbi situatën aktuale mund të mësoni më shumë në sitin www.transitionculture.org (blogu personal i Rob Hopkins) ose në www.transitiontowns.org/Totnes.

Iniciativa të tjera të tranzicionit

Lista e të gjitha komuniteteve në Britaninë e Madhe, Zelandë të Re, që kanë pranuar zyrtarisht modelin e tranzicionit për të pakësuar konsumin e energjisë dhe emetimin e dioksidit të karbonit, në nëndor 2007, është si vijon

- Totnes, Britani e Madhe- 8,500 banorë

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- Kinsale, Irlandë- 2,300 banorë
- Penwith, (lagje e West Cornwall) – popullsia: 64,000
- Ivybridge, Britani e Madhe-12,000 banorë
- Falmouth, Britani e Madhe - 20,000 banorë
- Moretonhampstead, Britani e Madhe: 1,500 banorë
- Lewes, Britani e Madhe: 16,000 banorw
- Stroud, Britani e Madhe: 12,000 banorë
- Ashburton, Britani e Madhe: 3,500 banorë
- Ottery St. Mary, Britani e Madhe: 7,500 banorë
- Bristol, Britani e Madhe: 400,000 banorë
- Brixton, Britani e Madhe: 65,000 banorë
- Forest Row, Britani e Madhe: 5,500 banorw
- Mayfield, Britani e Madhe: 2,500 banorë
- Glastonbury, Britani e Madhe: 9,000 banorë
- Lostwithiel, Britani e Madhe: 2,700 banorë
- Forest of Dean, Britani e Madhe: 80,000 banorë
- Nottingham, Britani e Madhe: 280,000 banorë
- Wrington, Britani e Madhe: 2,000 banorw
- Brighton&Hove, Britani e Madhe: 250,000 banorë
- Portobello, Edinburgh, Britani e Madhe: 10,000 banorë
- Market Harborough, Britani e Madhe: 20,000 banorë
- Sunshine Coast, Australi : 260,000 banorë
- West Kirby, Britani e Madhe: 13,000 banorë
- Llandeilo, Wells
- Bro Ddyfi, Wells

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- Whitstable, Angli
- Marsden & Slaithwaite, Angli
- Frome, Angli
- Brampton, Angli
- Isle of Wight, Angli
- Waiheke Island, Zelandë e Re
- Orewa, Zelandë e Re
- Dunbar, Skoci
- Rhayader, Wells
- Seaton, Angli
- Bath, Angli
- Exeter, Angli
- Isle of Man
- Canterbury, Angli
- Kapiti District, Zelandë e Re
- Carbon Neutral Biggar, qytet tranzicioni, Skoci
- Presteigne, Wells
- Wolverton, Angli
- Leicester, Angli
- Hollywood, Irlandë e Veriut
- Westcliff-on-Sea, Angli
- Isles of Scilly, Angli
- Liverpool South, Angli
- Norwich, Angli

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Ka dhe shumë komunitete të tjera të cilat na kanë kontaktuar dhe po konsiderojnë ngritjen e iniciativës së tyre lokale. Këto komunitete listohen në faqen <http://transitiontowns.org/TransitionNetwork/Mulling>

Presim që shumë prej tyre në vitet e ardhshme të përfshihen në listën zyrtare të iniciativave të tranzicionit.

Me përfshirjen e gjithmonë e më shumë komuniteteve në këtë proces, do të jemi në gjendje të krijojmë një rrjet social ku njerëzit do të këmbëjnë praktikatat më të mira, do të ndihmojnë njëri tjetrin për të krijuar një stil jetese shumë më të mirë se shoqëria e izoluar, e pabarabartë, me zhvillim jo të qëndrueshëm, në të cilën jemi rritur, kjo për shkak të naftës.

Krijimi i iniciativës suaj të tranzicionit – kriteret

Kemi përcaktuar një sërë kriteresh, të cilat tregojnë sa i përgatitur është një komunitet për të filluar ndryshimin e jetesës në një jetë me më pak energji. Nëse mendoni të përdorni modelin e tranzicionit për komunitetin tuaj, hidhni një sy listës dhe vlerësoni sinqerisht se sa i përmbushni këto kriteret. Gjatë krijimit të iniciativës duhet të fokusoheni sidomos në kriteret ku keni boshllëqe.

Kemi krijuar këto kriteret formale për të përcaktuar nëse një qytet ose fshat do të regjistrohet si qytet/fshat tranzicioni për këto arsye:

- Financuesit tanë duan të jenë të sigurtë, se ndërkohë që mbështesim projektet fillestare, vetëm komunitetet e përgatitura mirë do të fitojnë statusin zyrtar të tranzicionit. Komuniteteve të këtij statusi u japim mbështetje shtesë si psh. folësa, trajnime, forume.
- Me qëllim që të krijojmë programe të koordinuara (si psh. bileta të përbashkëta llotarie në llotarinë kombëtare) kemi nevojë të përcaktojmë kriteret të tilla për iniciativat e tranzicionit, që sigurojnë se këto janë të afta të marrin pjesë në programe të tilla.
- Kemi parë të paktën një komunitet të mbetet në stanjacion, sepse nuk kishin udhëheqësit e përshtatshëm ose përgatitjen e duhur dhe nuk e kuptonin mirë objektivin e lëvizjes.
- duhet të bëjmë dallimin midis iniciativës lokale të tranzicionit, rrjetit lokal të tranzicionit dhe rrjetit të përkohshëm (do e shpjegojmë më poshtë).



Kriteret

Kriteret ndryshojnë, nuk janë të ngurta:

1. Ndërgjegjësimi për efektet e ndryshimit të klimës dhe pikut të naftës si arsye të lëvizjes (për tu shkruar në dokumentat themelues të grupit)

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

2. një grup prej 4-5 personash që duan të marrin rol drejtues (jo vetëm entuziazmi i madh i një personi të vetëm)
3. të paktën dy persona nga grupi themelues që kanë dëshirë të marrin pjesë në një kurs trajnimi dy ditor. Këto në fillim janë në Totnes dhe me kalimin e kohës do të mbahen dhe në qytetet të tjera, përfshirë dhe në vende të tjera të botës. Trajnimi për momentin bëhet vetëm në Britaninë e Madhe, por po punojmë që kjo të ndryshojë.
4. një lidhje e fortë me organin e pushtetit vendor
5. një përvetësim i 12 hapave të tranzicionit (shiko më poshtë)
6. të dini të kërkonin ndihmë me raste
7. të përditësoni rregullisht faqen tuaj të internetit mbi lëvizjen tuaj të tranzicionit -

ose wikin (një sit i përbashkët në internet që do jua vëmë në dispozicion) ose faqen tuaj të internetit

8. të paktën çdo disa muaj të shkruani diçka në blogun e Qyteteve të Tranzicionit (bota po ju shikon).
9. të angazhoheni, që pas krijimit të iniciativës suaj, ti bëni të paktën 2 prezantime komuniteteve të tjera që janë në afërsinë tuaj dhe që mendojnë të përfshihen në iniciativë- një farë seminari “ja se çfarë kemi bërë” apo “ja se çfarë mësuam”
10. të angazhoheni në bashkëpunim me komunitete të tjera të përfshira në tranzicion
11. të mos ketë konflikte interesi në grupin themelues
12. të angazhoheni me Rrjetin e Tranzicionit për të kërkuar grante nga shoqata dhe fondacione kombëtare. Ndërkohë nga shoqatat dhe fondacionet lokale mund të kërkonin grante vetëm.
13. një angazhim për të bërë lëvizjen gjithëpërfshirëse. Ka rëndësi të theksohet ky moment sepse ka shqetësime se grupe politike ekstremiste po angazhohen në lëvizje. Një mënyrë për të theksuar qëllimin gjithëpërfshirës të lëvizjes është deklarimi i mbështetjes së lëvizjes të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut të OKB-së, aprovuar me rezolutën 217 A (III) të OKB-së, më 10 Dhjetor 1948. Kjo mund ti shtohet statutit me qëllim që grupe politike ekstreme të cilat praktikojnë diskriminimin të mos përfshihen në organet drejtuese të iniciativës suaj. Një grup brenda rrjetit tonë po përpiqet të gjejë mënyrat më të mira për të parandaluar përfshirjen e grupeve ekstremiste në lëvizje.
14. vetëdija se megjithëse në tranzicion do të duhet të përfshihet gjithë qyteti ose lagjia juaj, fillimisht ndryshimet duhet të bëhen në komunitetin lokal. Me kalimin e kohës dhe përfshirjen në lëvizje të më shumë komuniteteve në zonën tuaj do të lindë nevoja për një grup qendror i cili do të japë mbështetje lokale, por kjo do të vijë natyrshëm. Kjo pikë theksohet sepse ka pasur disa raste kur aktivistët kanë nxituar të përfshijnë në lëvizje gjithë qytetin/rajonin. Në raste të veçanta kur duhet ngritur një rrjet koordinues ose rrjet inicjues (aktualisht në Bristol, Forest of Dean, Brighton&Hove) ai rrjet do të jetë përgjegjës që ky kriter të aplikohet në të gjithë iniciativat e zonës së vet.

Rrjeti mendohet të ketë përgjegjësi shtesë për mbështetje dhe trajnim. Ka dhe kritere të tjera për të krijuar/koordinuar rrjete tranzicioni-këto diskutohen me personin që dëshiron ti krijojë.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

15. Rekomandojmë që të paktën një person nga grupi themelues të ketë ndjekur kurs permakulture, mendojmë se kjo ndihmon shumë.

Nëse arrini të na tregoni se i keni plotësuar këto kritere dhe jeni gati të filloni rrugëtimin tuaj drejt tranzicionit, do të gjeni tek ne mbështetje, udhëzime, materiale, shërbime interneti, trajnime, mundësi bashkëpunimi dhe financime. Dera është gati të hapet, detaje kontakti mund të gjeni në fund të këtij dokumenti.

Organizimi i lëvizjes së tranzicionit – tipa të ndryshëm organizimi

Iniciativa e tranzicionit mund të organizohet në 4 modele të ndryshme:

1. **“iniciativa lokale e tranzicionit”** – organizohet në nivel lokal, grupi themelues frymëzon dhe organizon komunitetin lokal. Kjo është forma kryesore e organizimit.
2. **“rrjeti lokal i tranzicionit”** – organizohet në nivelin e një sipërfaqeje të madhe, të vazhduar, si psh. qytet. Mbështet dhe ndihmon në krijimin e iniciativave lokale të tranzicionit.
3. **“rrjeti i përkohshëm i tranzicionit”** – përbëhet nga disa anëtarë dhe krijohet vetëm me qëllimin e ngritjes së iniciativave lokale të tranzicionit në zonat e tyre të banimit, pas krijimit të të paktën dy cilave shpërbëhet.
4. **“rrjeti rajonal koordinues”** – më shumë se sa një organizatë, është një asamble e iniciativave të tranzicionit të cilat mbledhen për të këmbyer mbështetje, burime dhe për të zgjedhur përfaqësues të përbashkët.

Diçka më tepër për iniciativën lokale të tranzicionit

Kjo është forma më e shpeshtë dhe më e thjeshtë e iniciativave, zakonisht në zona me deri në 15000 banorë. Psh. iniciativa të tilla janë në Totnes, Lewes, Wrington, Portobello në Edinburg. Këto iniciativa janë motorët e ndryshimit, funksionojnë në nivel lokal me përfshirjen e banorëve të zonës. Pa këto nuk ka lëvizje tranzicioni.

Diçka më shumë për rrjetin lokal të tranzicionit

Roli i këtij grupi është të nxisë krijimin e iniciativave lokale në zonën që mbulon dhe të frymëzojë, inkurajojë, regjistrojë, mbështesë, ndërmjetësojë dhe mundësisht trajnojë këto iniciativa. Kjo kërkon kohë dhe rrjetet e reja dhe ato që operojnë pa burime financiare nuk arrijnë ti përmbushin këto funksione që në fillim.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Shpresojmë që rrjetet dhe iniciativat lokale të mbështesin njëra tjetrën, fillimisht jo formalisht. Shpresojmë që brenda një zone iniciativat do të bashkëpunojnë dhe mbështesin njëra tjetrën, në dobi të vetë iniciativave si dhe të zonës.

Jemi vetëm në ditët e para të një eksperimenti masiv të tranzicionit dhe organizimi mund të ndryshojë në bazë të përvojës që do të fitojmë.

Aktualisht rrjete lokale tranzicioni ka në Tynedale dhe Forest of Dean.

Rrjeti lokal i tranzicionit është gjithashtu përgjegjës për mbikëqyrjen e iniciativave lokale të tranzicionit. Rrjeti evidenton dhe nxit iniciativat lokale që kanë fituar eksperiencë të aplikojnë në Rrjetin e Tranzicionit për të marrë status zyrtar. Mendojmë se në të ardhmen regjistrimi i komuniteteve që janë njohur zyrtarisht do të kryhet nga rrjeti lokal i tranzicionit.

Rrjeti lokal i tranzicionit do të ndihmojë komunikimin me iniciativat lokale në zonën e mbuluar prej tij.

Nëse një grup dëshiron të funksionojë si rrjet lokal tranzicioni, duhet të tregojë se është i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që merr pësipër dhe është në gjendje ti kryejë detyrat e rrjetit. Për të gjykuar mbi grupin kryhen disa bisedime dhe takime me stafin tonë.

Planifikojmë të krijojmë një asamble rrjetesh lokale tranzicioni, dhe ka shumë të tillë, ku do të diskutohen problematikat e organizimit.

Mendojmë se funksionimi i rrjetve lokale të tranzicionit ka rëndësi në qytete, dhe në fshatra me shumë banorë, por një rolë të madh në organizim do të ketë intuata e iniciatorëve.

Është përvojë e re dhe jo e thjeshtë...prandaj veproni me kujdes.

Rrjeti i përkohshëm i tranzicionit

Ky lloj grupi përbehet nga grupe të organizuara në vende të ndryshme në të njëjtin rajon, të cilët bashkëveprojnë me njëri-tjetrin.

Qëllimi i grupit të përkohshëm është të nxisë lindjen e iniciativave lokale të tranzicionit dhe pas arritjes së objektivit shpërbëhet. Anëtarët e tij bëhen anëtarë të iniciativave lokale kur këto arrijnë përmasat minimale për tu quajtur të tilla.

Pra roli i rrjetit të përkohshëm është vetëm inspirues, pa pasur përgjegjësi të tjera si rrjet.

Rrjete të tilla funksionojnë në West Berkshire dhe disa zona të tjera. Me krijimin e iniciativave lokale këto i drejtohen Rrjetit të Tranzicionit për mbështetje si trajnim etj.

Rreth Rrjetit Rajonal të Tranzicionit

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Për të kontaktuar me administratën e të gjitha niveleve-lokale, rajonale dhe qendrore-nevojitet dhe janë krijuar struktura të veçanta.

Prandaj Rrjeti i Tranzicionit, bazuar në përvojën e vet dhe të iniciativave të tranzicionit, ka përcaktuar disa kritere për të njohur rrjetet rajonale të tranzicionit:

o Një pjesë e konsiderueshme e iniciativave të tranzicionit (si ato të njohura zyrtarisht dhe ato të sapo krijuara) të zonës ku do të veprojë rrjeti rajonal kanë rënë dakort ta krijojnë, dhe

o përfaqësuesit dhe drejtuesit e rrjetit rajonal zgjidhen nga lëvizjet e tranzicionit të zonës që do të mbulojë rrjeti rajonal.

Kritere të tjera janë në shqyrtim e sipër.

Mendojmë se kriteret janë të nevojshme për të pasur një rrjet rajonal autentik, të autorizuar, të përgjegjshëm, transparent, me përvojë dhe të motivuar.

Konkluzione

Si gjithmonë, rregullat janë të ndryshueshme në varësi dhe të zhvillimeve, me qëllim që objektivat të arrihen.

Krijimi i iniciativës së tranzicionit-organet drejtuese dhe statuti

Dokumentat kryesorë të organizatës– rregulloret, statuti

Çdo organizatë ka nevojë për statut. Disa njerëz preferojnë ti shmangen hartimit të statudit por ai është i domosdoshëm dhe shërben si referencë për anëtarët e organizatës. Është edhe detyrim ligjor.

Shpresojmë që organizatat e regjistruara formalisht të përfshijnë objektivat e tyre demokratike dhe gjithpërfshirëse në statutet e tyre.

Nëse vërejmë se statutet janë të ngjashme me njëri tjetrin në të ardhmen mund të nxjerrim dhe një model statuti.

Gjithsesi është më mirë të krijoni statutin tuaj unik (megjithëse kjo mund t'ju irritojë disi)!

Një pikë shqetësimi i iniciativave në të gjithë botën është përfshirja e mundshme e grupeve ekstreme politike. Një mënyrë për ta shmangur këtë është përmendja në statut e mbështetjes së Deklaratës Ndërkombëtare të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Kjo do të pengojë përfshirjen në shoqatë të grupeve që kanë si qëllim të tyrin diskriminimin.

7 probleme që mund të hasni në iniciativën tuaj

Pasi keni arritur deri këtu me leximin tuaj mund të mendoni se krijimi i një iniciative në komunitetin tuaj do të ishte me interes.

Seksioni tjetër do ju orientojë në udhëtimin tuaj por fillimisht duhet të kapërceni pengesat që do të hasni-të vërteta ose të imagjinuara. Këto i quajmë “7 por-et”

-Por 1: Nuk kemi fonde.

Kjo nuk është pengesë. Fondet nuk mund të zëvendësojnë entuziasmin dhe përfshirjen e komunitetit, të cilat do ju ndihmojnë në fazat e para të tranzicionit. Financuesit mund të kërkojnë të kenë kontroll mbi lëvizjen dhe kjo mund të bjerë ndesh me interesat e komunitetit.

Do ju tregojmë sesi të mund të krijoni të ardhura gjatë procesit. Nuk flasim për të ardhura të mëdha, nuk bëhet fjalë të regjistroheni në bursë, por siç ka thënë dhe dizenjuesi i fshatrave ekologjike Max Lindeggar disa vite më parë “nëse një projekt nuk krijon fitime, do të krijojë humbje”

Qyteti Totnes filloi tranzicionin në Shtator 2005 dhe lëvizja e qytetit nuk kishte fare fonde, por që atëhere ka arritur të vetë-financohet. Transmetimet e filmave, bisedat në publik kanë sjellë të ardhura për të mbështetur aktivitete si Ditët në Ambjente të Hapura. Do të vijë një moment kur ndonjë projekt specifik do të kërkojë financim por deri atëhere do të arrini të vetë-financoheni. Mos lejoni që mungesa e fondeve t’ju pengojë.



-Por 2: Na pengojnë ...

Ka një frikë midis aktivistëve ambientalistë se një iniciativë që është e suksesshme dhe arrin të sjellë ndryshime do të mbyllet, nënshtrohet, sulmohet nga burokratë dhe korporata të paskrupullta. Nëse kjo frikë është aq e fortë sa t’ju pengojë në aktivitetin tuaj, nëse e vetmja gjë që doni të bëni është ti nënshtroheni të panjohurve “atyre”, atëhere jeni duke lexuar dokumentin e gabuar. Qytetet e Tranzicionit nuk duan të bëjnë as armiq dhe as viktima. Dhe prandaj nuk duket se kanë armiqësuar ndonjë institucion.

Në të kundërt, me ndërgjegjësimin e korporatave për zhvillimin e qëndrueshëm dhe ndryshimin e klimës, do të habiteni sesa njerëz me pushtet do të entuziazmohen dhe frymëzohen nga ajo çka jeni duke bërë, dhe do ju mbështesin, në vend që t’ju pengojnë në përpjekjet tuaja.

Por 3: Ka grupe ambientaliste të shumta në qytet dhe nuk dua t’ju prek interesat

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Për këtë do të flasim më gjerë në seksionin tjetër, nën hapin 3, por me shumë mundësi nuk do të armiqësoni grupet ambjentaliste. Iniciativa juaj do të japë një objektiv të përbashkët grupeve aktuale ambjentaliste, disa prej të cilave mund të kenë humbur hovin e fillimit dhe kanë nevojë për frymën e re që ju do të sillni.

Bashkëpunimi me grupet ambjentaliste për realizimin e Planit të Aksionit për Pakësimin e Energjisë do të shtojë punën e tyre, në vend që ta zëvendësojë apo duplikojë atë. Grupet ambjentaliste mund të bëhen aleatët tuaj të fortë, dhe kjo ndihmon suksesin e tranzicionit.

Por 4: Por asnjë në këtë qytet nuk shqetësohet për mjedisin

E kuptojmë përse mund të mendoni kështu, mjafton të shikojmë kulturën konsumeriste apatike që na rrethon. Megjithatë, gërmoni më thellë, se njerëzit nga të cilët e prisni më pak janë mbështetësit më të mëdhenj të elementëve kryesorë të iniciativës së tranzicionit-ushqimi lokal, zanatet lokale, historia dhe kultura lokale.

Duhet të shkoni tek ata, në vend që të prisni të vinë ata tek juve. Shikoni çfarë keni të përbashkët me ta, dhe komuniteti juaj do ju duket më interesant se çë mendoni.



Por 5: Është shumë vonë tashmë...

Mund të jetë vonë, por mund dhe të mos jetë vonë. Kjo do të thotë se përpjekjet tuaja dhe të të tjerëve janë absolutisht shumë të rëndësishme.

Mos lejoni që dëshpërimi t'ju sabotojë përpjekjet, sikurse thotë Vandana Shiva “pasiguria e kohërave tona nuk është arsye për tu dëshpëruar”.

Por 6: Nuk kam kualifikimet e duhura..

Nëse nuk veproni, kush do të veprojë? Nuk ka rëndësi nëse nuk keni doktoraturë në zhvillimin e qëndrueshëm, apo vite eksperiencë në kopshtari apo planifikim. Çfarë ka rëndësi është se ju shqetëson e ardhmja e vendit ku jetoni, se e kuptoni se ka nevojë për veprim, dhe se jeni të hapur për ide të reja në angazhimin e njerëzve.

Kualifikimet që duhet të ketë një person për të filluar një iniciativë tranzicioni, nëse do e konsideronim si një vend pune, do të ishin:

- Pozitiv
- I dashur me njerëzit
- Njohje e mirë e vendit dhe e njerëzve më të rëndësishëm të qytetit.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Kjo është e gjitha. Roli juaj në këtë fazë është si e kopshtarit që punon tokën për ta mbjellë më vonë.

Por 6: Nuk kam energji për këtë

Siç ka thënë Gëte: “filloni të bëni çfarëdo gjëje që mund të bëni ose imagjinoni se mund të bëni. Iniciativa ka gjenialitet, fuqi dhe magji në të”. Eksperienca me iniciativat e tranzicionit na mëson se kjo është e vërtetë. Megjithëse idea e përgatitjes së qytetit, lagjes apo ishullit tuaj për jetën pa naftë mund të duket tronditëse në pasojat e saj, energjia e çliruar nga iniciativa e tranzicionit është e pandalshme.

Mund të ngurroni për shkak të gjithë kompleksitetit dhe madhësisë së punës, por njerëzit do ju ndihmojnë. Në fakt, shumë njerëz kanë komentuar qetësinë me të cilën zhvillohet i gjithë procesi, se si njerëzit e duhur gjinden në kohën e duhur. Ka diçka në marrjen e iniciativës, nga “pse nuk po bëhet asgjë” filloni të mendoni “le të bëjmë diçka atëherë”, dhe kjo ju frymëzon me energji për të vazhduar.

Shpesh, ngritja e organizatave ambientaliste është si të shtysh një makinë të prishur në një të përpjetë kodre; e vështirë, punë e vështirë pa duk. Lëvizja e tranzicionit është sikur po këtë makinë e shtyni në anën tjetër të kodrës: makina fillon të lëvizë aq shpejt sa që nuk e ndiqni dot. Me shtyrjen nga maja e kodrës makina do të fitojë inercinë e vet. Me këtë nuk duam të themi se ndonjëherë nuk do të lodheni, por pothuajse gjithmonë është kënaqësi.

12 hapat e tranzicionit

Këto 12 hapa janë udhëzime të lindura nga përvoja e deritanishme, sidomos në qytetin Totnes.

Këto nuk janë të detyrueshme. Secila shoqatë mund të shtojë pika të tjera, të mos marrë parasysh ndonjë prej tyre, ti riorganizojë për nga rëndësia.

Gjithsesi, mendojmë se do të jenë pikat më të rëndësishme gjatë aktivitetit tuaj dhe do ju ndihmojnë në vitet e para të punës suaj.

Hapi #1. Krijoni një grup themelues i cili do të shpërbëhet më vonë.

Ky grup do të nevojitet për realizimin e projektit në fazat e para të tij.

Rekomandojmë që grupi të jetë në funksion gjatë hapave 2-5 dhe me formimin e të paktën 4 nën-grupeve, grupi themelues shpërbëhet. Kjo kërkon njëfarë modestie por është e rëndësishme për arritjen e suksesit të projektit. Grupi themelues pasi shpërbëhet rikrijohet me anëtarë përfaqësuesit e nën-grupeve.

Hapi #2. Fushata e ndërgjegjësimit

Në këtë fazë do të identifikohen aleatët tuaj, do të krijohen lidhjet dhe do të përgatitet komuniteti për fillimin e iniciativës së tranzicionit. Që të ndërtohet një plan aksioni efektiv për pakësimin e energjisë,

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

pjesëmarrësit e tij duhet të kuptojnë efektet potenciale si të pikut të naftës ashtu dhe të ndryshimit të klimës -ku e para kërkon përshtatjen e komunitetit, kurse e dyta pakësimin e emetimit të dioksidit të karbonit

Transmetimi i filmave më të shikuar për temat (e Vërteta e Pathënë, Fundi i rrethinave të qyteteve, Zgjimi i Befte, Pushteti i Komunitetit) dhe pyetje-përgjigje me ekspertin në fund të transmetimit, janë shumë efektive (shikoni seksionin tjetër për më shumë informacion për filmat).

Bisedat e ekspertëve për ndryshimin e klimës dhe pikun e naftës dhe zgjidhjet e mundshme janë shumë frymëzuese.

Artikuj në gazetata lokale, intervista në radion lokale, prezantime grupeve të qytetarëve, përfshirë shkollat, janë gjithashtu mënyra ndërgjegjësimi për qytetarët që të kuptojnë problemin dhe të fillojnë të mendohen për zgjidhjet.

Hapi #3. Hedhja e themeleve

Në këtë hap duhen krijuar lidhjet me grupet dhe aktivistët ekzistues, qartësimi i tyre se iniciativa e tranzicionit ka për qëllim të përfshijë përpjekjet e deritanishme dhe të ardhshme të shoqatave të tjera, por duke i parë në një këndvështrim tjetër. Pranoni dhe respektoni punën e shoqatave të tjera dhe theksoni se ato kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur. Përshtetësi saktë dhe qartë pikun e naftës, çfarë do të thotë, çfarë lidhjeje ka me ndryshimin e klimës, si mund të ndikojë në komunitet dhe problemet që krijon. Gjenero mënyra si shoqata juaj mund të nxisë komunitetin të kërkojë zgjidhje.



Hapi #4. Promovimi i aktiviteteve të shoqatës

Në këtë hap synohet promovimi i shoqatës në komunitet. Mendojmë se promovimi është më mirë të bëhet rreth 6 muaj-1 vit pas transmetimit të filmave ndërgjegjëses.

Promovimi zyrtar i lëvizjes së tranzicionit në Totnes u bë në Shtator 2006, rreth 10 muaj pas bisedave, filmave dhe takimeve të para.

Promovimi do të synojë të aktivizojë njerëzit të veprojnë për ndryshimin e klimës dhe pikun e naftës, por me frymën “mund të bëjmë diçka për zgjidhjen e problemit”, sesa “po vjen fundi i botës”

Një prezantim mbi barrierat psikologjike dhe praktike ndaj ndryshimit të jetës së përditshme mund të shërbejë fare mirë qëllimin.



Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Nuk është e thënë të bëhen vetëm biseda, mund të bëhen takime të shoqëruara me muzikë, ose koktail, opera, vallëzim apo çfarëdo aktiviteti që është i përshtatshëm në komunitetin tuaj.

Hapi #5. Formimi i grupeve të punës

Për të bërë planin e aksionit për pakësimin e energjisë nevojitet gjenialiteti i komunitetit. Për aspekte të veçanta të planit krijohen grupe të veçanta pune. Secili grup do të ketë aktivitetet e veta, brenda projektit kryesor. Grupet e punës duhen krijuar për çdo aspekt që ka rëndësi për mbijetesën dhe vazhdimësinë e komunitetit.

Shembuj të kësaj janë: ushqimi, përpunimi i mbeturinave, energjia, të rinjtë, ekonomia, transporti, furnizimi me ujë, qeverisja lokale. Çdo grup pune do të analizojë dhe do të përpiqet të përcaktojë mënyrat më të mira të përshtatjes ndaj pikut të naftës dhe pakësimit të emetimit të dioksidit të karbonit.

Zgjidhjet që do të gjejnë grupet e punës do të përfshihen në planin e aksionit për pakësimin e energjisë.

Hapi #6. Përdorimi i ambjenteve të hapura

Mendojmë se takimet në ambjente të hapura janë shumë efikente. Në teori duket sikur nuk funksionojnë. Një grup i madh njerëzish mbledhet për të biseduar mbi një temë të caktuar, pa një axhendë, pa afat, pa koordinator dhe pa procesverbale.

Megjithatë kemi mbajtur takime në ambjente të hapura për ushqimin, energjinë, ndërtimin, ekonominë dhe psikologjinë e ndryshimit. Në çdo takim pjesëmarrësit ndanë mendimet e tyre, mbajtën shënim ato që dëgjuan, u njohën me njëri tjetrin dhe me idetë e shumta. Broshura e Harrison Owen-it “Teknologjia e takimeve në ambjente të hapura: Udhëzues” ka shumë informacion. Gjithashtu, libri i Peggy Holman dhe Tom Devane “Libri për ndryshimin: metodat për të ndryshuar të ardhmen në grup” ka informacion më të gjerë.

Hapi #7. Krijoni nën-projekte me vlerë praktike

Lëvizja juaj nuk është thjesht një mbledhje njerëzish ku pjesëmarrësit rehatohen dhe nxjerrin listën e tyre me dëshira. Që në fillim të tij lëvizja duhet të ketë projekte me zbatime të dukshme në praktikë.

Kjo do të shtojë njohjen e lëvizjes dhe dëshirën e njerëzve për të marrë pjesë në të.

Duhet ruajtur ekuilibri, sidomos në fillimet e lëvizjes. Duhet të përparoni dukshëm, pa inicuar projekte pa vlerë.

Në qytetin e tranzicionit Totnes, grupi i punës i ushqimit filloi projektin “Totnes-kryeqyteti i arrave, lajthive dhe bajameve në Britani” i cili përpiqet të mbjellë sa më shumë pemë të tilla në qytet.



Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Me ndihmën e kryetarit të bashkisë, mbollëm disa pemë të tilla në qendër të qytetit dhe i krijuam shumë reklamë evenimentit.

Hapi #8. Mësimi i zanateve të reja

Për të jetuar me më pak energji dhe ri-lokalizuar komunitetet, do të duhet të mësojmë dhe praktikojmë shumë tradita të së kaluarës. Një nga gjërat më të dobishme që mund të kryejë një shoqatë tranzicioni është të trajnojnë në zanatet dhe traditat e vjetra.

Rekomandojmë marrjen e informacionit nga më të moshuarit: ata kanë jetuar përpara kohërave të konsumerizmit dhe e dinë se si funksionon një shoqëri me pak energji. Disa trajnime që mund të bëhen janë: riparime, gatime, ndërtim me materiale natyrale, izolimi i çatave, lysterja, bimët mjekësore, kopshtaria, efiçenca energjitike e shtëpive, gatimi i bukës me brumë të ardhur, kultivimi (lista nuk ka fund).

Programi i trajnimit i ndihmon njerëzit të kuptojnë aftësinë e tyre në zgjidhjen e problemeve dhe i ndihmon të bashkëpunojnë me njëri tjetrin. Ndërkohë që mësojnë madje dhe argëtohen.



Hapi #9. Komunikimi me qeverisjen vendore

Sado projekte praktike të keni arritur të inicioni, sado të mrekullueshme të jenë planet tuaja të pakësimit të energjisë, nuk do të shkoni larg nëse nuk krijoni marrëdhënie pozitive dhe produktive me qeverisjen vendore.

Si për planifikimin e takimeve, gjetjen e fondeve apo krijimin e lidhjeve, qeverisja vendore duhet të jetë në krahun tuaj. Mund të surprizoheni në mbështetjen që mund të gjeni.

Po shikojmë mundësinë të bëjmë një plan aksioni për pakësimin e energjisë për Totnesin në një format të ngjashëm me strategjinë e zhvillimit të qeverisjes vendore. Ndoshta një ditë, urbanistët e bashkisë do të ulen përpara tavolinës me dy dokumenta përpara tyre: strategjinë standarte të zhvillimit të qeverisjes vendore dhe planin e aksionit për pakësimin e energjisë, të prezantuar bukur.

Kjo rreth 2008, ditën kur çmimi i naftës do të kapërcejë 100 dollarë barrela. Urbanistët lexojnë të dy dokumentat dhe konkludojnë se vetëm plani i aksionit për pakësimin e energjisë adreson sfidat e kohës. Me kalimin e planit të aksionit në qendër të vëmendjes, strategjia standarte humbet në koshin e mbeturinave (ëndërrojmë sikur!)

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Hapi #10. Respektimi i të moshuarve

Për të lindurit në vitet 1960, kur prodhimi i naftës arriti kulmin, është e vështirë të përfytyrohet jeta me më pak naftë. Çdo vit (përfshirë krizën e naftës të viteve 70) është konsumuar më shumë energji se në vitet paraardhëse. Që të rikrijojmë tablonë e një shoqërie me më pak energji duhet të përfshijmë në lëvizje personat që kanë përjetuar kalimin e shoqërisë në shoqëri konsumeriste, sidomos ata që kanë jetuar në vitet 1930-1960. Duhet të shmangni përshtypjen se kërkon të ktheni kohën pas, por mund të mësohet shumë nga e kaluara: si bëheshin gjërat, si organizohej shoqëria, si plotësoheshin nevojat e përditshme. Zbulimi i së kaluarës do ju mësojë gjëra të reja dhe do të ndjeheni më të përkushtuar ndaj komunitetit.



Hapi #11. Le të marrin ngjarjet rrjedhjen e tyre të natyrshme...

Megjithëse mund të filloni organizimin e lëvizjes me një ide të qartë, është e pashmangshme që të keni surpriza. Nëse këmbngulni në vizionin tuaj, do të pengoni zhvillimin dhe do të lodheni. Nuk është roli juaj të jepni të gjitha përgjigjet, por të nxisni komunitetin të bëjë tranzicionin e vet.

Mjafton të fokusoheni në kriteret bazë-forcimi i komunitetit dhe pakësimi i emetimit të dioksidit të karbonit-dhe vetë komuniteti do të gjejë zgjidhjet praktike, të zbatueshme dhe krijuese.

Hapi #12. Krijimi i planit të pakësimit të energjisë



Grupet e punës kanë studiuar hapa dhe zgjidhje konkrete për përshtatjen e komunitetit dhe pakësimin e emetimit të dioksidit të karbonit. Të gjitha këto zgjidhje dhe hapa konkretë përbëjnë planin e aksionit për pakësimin e energjisë. Në këtë plan shfaqet gjenialiteti i komunitetit për të formuar të ardhmen e vet në përshtatje të ndryshimit të klimës dhe pikut të naftës.

Krijimi i këtij plani nuk është fare e thjeshtë. Është një plan që ndryshon me kalimin e kohës.

Ndihmë prej nesh – modeli i tabelës së burimeve natyrore lokale

Përmbledhja e burimeve lokale-ato që janë aktualisht ose që mund të krijohen në të ardhmen, çfarë burimesh nevojiten aktualisht ose do të nevojiten në të ardhmen- ka shumë rëndësi për krijimin e një plani aksioni realist. Prandaj po bëjmë një model tabele për ta ndihmuar procesin.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Ndihmë prej nesh për përgatitjen e afateve të tranzicionit

Po punojmë me shkencëtarë të ndryshimit të klimës, ekologjistë, analistë energjie dhe ekonomistë ambjentalistë për të krijuar një grafik afatgjatë të afateve për realizimin e planit të aksionit.

Mbështetje prej nesh : treguesit e transformimit të komunitetit

Këtu do të shpjegojmë konceptin e treguesve të transformimit të komunitetit. Transformimi krijon aftësinë e komunitetit për tu bërë ballë ndryshimeve. Treguesit na ndihmojmë ta masim këtë.

Tradicionalisht pakësimi i efekteve degraduese të konsumit të naftës kërkon pakësim të emetimit të dioksidit të karbonit. Besojmë se pakësimi i emetimit pa forcuar komunitetin nuk është zgjidhje e mjaftueshme nëse duam të përshtatemi si ndaj ndryshimit të klimës ashtu dhe ndaj pikut të naftës.

Si mund të përcaktojmë nëse komuniteti po transformohet?

Treguesit e transformimit:

- % e ushqimit që kultivohet në vend
- % e monedhës vendase ndaj monedhës totale në qarkullim
- % e bizneseve që zotërohen nga vendasit
- largësia mesatare e vendit të punës nga vendbanimi, për të punësuarit
- largësia mesatare e vendit të punës nga vendbanimi për banorët e qytetit që punojnë jashtë tij
- % e energjisë që prodhohet lokalisht
- sasia e materialeve ndërtuese të rinovueshme
- % e artikujve që prodhohen në vend brenda një sipërfaqeje të caktuar
- % e mbetjeve organike që përpunohen për pleh organik


Disa tregues janë të vlefshëm për të gjithë komunitetet, kurse tregues të tjerë janë specifikë për komunitete të caktuara. Po punojmë të krijojmë një listë të plotë të treguesve të elasticitetit dhe do i publikojmë kur ta kemi gati.

Plani i aksionit për pakësimin e energjisë (PAPE)

Ka aktivistë të cilët e quajnë këtë “rrugë”, ose “vizion”. Quajeni si të doni.

Në thelb PAPE jep një tablo të jetës së komunitetit, kaq të bukur, të parezistueshme, sa që çdokush do të dëshironte ta realizonte atë.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit



Ja se si mund të bëhet plani (nga çfarë kemi mësuar deri tani):

1. **Krijoni një databazë me të dhëna për ekonominë vendore:** mblidhni të dhëna mbi të gjitha fushat e jetës për të cilat keni krijuar grupe pune: tokë bujqësore, transport, shërbime mjekësore,

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

burime alternative energjie, aftësi prodhimi tekstilësh, ndërtim. Kjo mund të bëhet dhe në momentin kur ngrihen grupet e punës.

- “Rrjeti i Tranzicionit” do ju ofrojë modele databazi.
2. **Jepni vizionin tuaj të komunitetit** në 15-20 vitet e ardhshme nëse arrihet të pakësohet në mënyrë drastike emetimi i dioksidit të karbonit, konsumi i naftës dhe komuniteti transformohet.
 - “Rrjeti i Tranzicionit” do ju ofrojë listën e treguesve të transformimit me qëllim që të keni ku të fokusoheni.
 3. **Nga e ardhmja në të tashmen:** vendosni afate për arritjen e objektivave të planit, kërkesat për arritjen e objektivave, aktivitetet e nevojshme për të arritur objektivat. Treguesit ndihmojnë në përgatitjen e grafikut.
 - Si ndihmë Rrjeti i Tranzicionit do ju japë grafikun për tranzicionin në Britaninë e Madhe.
 4. **Siguroni strategjinë vendore të zhvillimit** dhe strategjinë e bashkëpunimit të qeverisjes vendore. Strategjitë e tyre zakonisht kanë afate që do t’ju duhet ti merrni në konsideratë.
 5. **Tregime për tranzicionin:** është krijuar një grup pune për të shkruar artikuj, tregime, filma dhe prezantime mbi vizionin e komunitetit, si do të arrijmë ta transformojmë dhe çfarë do të ndodhë gjatë procesit.
 6. **Krijoni draftin e parë të PAPE:** bashkoni në një planin dhe tregimet mbi tranzicionin dhe kalojeni draftin për rishikim dhe konsultim.
 7. **Finalizimi i PAPE:** përfshini në draftin e PAPE ndryshimet pas komenteve. Në fakt, ky dokument (nëse do të kthehet në të tillë) nuk do të jetë asnjëherë përfundimtar- do të azhurnohet vazhdimisht me ndryshimin e kushteve dhe daljen e ideve të reja.

Me ndërtimin e planeve të aksionit nga shoqata të ndryshme edhe planet do të perfeksionohen me kalimin e kohës. Rrjeti i Tranzicionit ka plane të mbështesë krijimin e planeve të aksionit duke ofruar listën e treguesve të transformimit dhe grafikun e afateve të objektivave për energjinë, klimën, ushqimin etj.

Video të 12 hapave drejt tranzicionit

Në YouTube ka video të Rob Hopkins ku ai prezanton 12 hapat e tranzicionit në një konferencë në Maj 2007, në adresën http://www.youtube.com/results?search_query=rob+hopkins+twelve+steps

Në të njëjtën adresë, nëse hiqni "twelve steps" do të gjeni një sërë videosh të intervistimeve të Rob Hopkins nga Adrienne Campbell.

Tranzicioni në një kontekst më të gjerë

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Vetëm në Britaninë e Madhe dhe në Wells, ka rreth 11,000 bashki të vogla dhe komuna, 60 qytete dhe një numër i madh komunitetesh rurale të cilat do të preken nga pakësimi i energjisë, dhe do të përshtaten ose duke vepruar ose duke pritur të keqen.

Por, përveç transformimit në nivel komuniteti, çdo individ do të duhet të ndryshojë dhe të pakësojë vartësinë e tij nga nafta dhe të lerë praktikën degraduese për ambientin. Çdo individ do të duhet ti largohet paradigmes së rritjes ekonomike pa limite. Për disa do të jetë më e lehtë se për të tjerë, por është një ndryshim që do të duhet ta bëjmë të gjithë.

Dhe secili prej nesh duhet ta kuptojë thellë brenda vetes se nëse dëshirojmë të jetojmë akoma mbi tokë, do të duhet të bëhemi pjesë e planetit dhe të pranojmë se paradigma “njerëzit janë të pavarur nga toka” që përshkon shoqërinë tonë të industrializuar është e gënjeshtërt, dizorientuese, një biletë pa kthim drejt një ferri mbi tokë, shumë më të nxehtë seç mund të përballojmë ne.

Ky udhëtim kërkon të ndjehet plotësisht peshën e rëndë të përgjegjësisë për atë ç’ka po ndodh, bashkëfajësinë e të gjithëve ne në ushqimin e kësaj paradigme jo jetëgjatë.

Disa e ndjehet dhimbjen e Tokës dhe kjo i dërrmon. Ky udhëtim karakterformues kryhet më mirë në shoqëri, për të ndarë barrën dhe mbështetur njëri-tjetrin. Nëse i futeni kësaj rruge të vetmuar, vetmia nuk do ju lërë ta çoni deri në fund.


Prandaj gjeni persona të vendosur si ju dhe kridhuni në aksion. Dhe kur të dilni në bregun tjetër, më të zgjuar, të transformuar dhe më të vendosur, do të jini udhërrëfyes për ata që vijnë pas jush. Nevoja e tyre do të jetë më e madhe se e juaja.

Ja disa thënie të cilat përshkruajnë me pak fjalë nevojën për tranzicionin:

“Duhet të gjejmë një mënyrë të jetojmë në këtë planet pa mbyllur sytë të shikojmë se çfarë po bëjmë”

– Joanna Macy

"Krijimi i problemeve është shumë më i lehtë se zgjidhja e tyre." – Albert Einstein



"Detyra jonë është të përfshijmë nën kujdesin tonë të gjitha qeniet e gjalla dhe gjithë natyrën në bukurinë e saj" – Albert Einstein

"Nqs. më përpara bënim gjueti dhe mblidhnim ushqime ne pyll, tani bredhim dyqaneve dhe marrim borxh" – Robin Williams, 1990

"Nëqoftëse bota do të duhet të shpëtohet nga njeriu, jam e sigurtë se kjo do të bëhet nga njerëz të zakonshëm, dashuria e të cilëve për jetën është më e madhe se frika për të." – Joanna Macy

"Sa herë që shikoj dikë me biçikletë, më ikën dëshpërimi për të ardhmen e njerëzimit " – H.G. Wells

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

“Nëse transformimi i madh do të dështojë, kjo nuk do të jetë për shkak të mungesës së teknologjisë apo të të dhënave, por për shkak të mungesës së vullnetit politik. Kur të jemi të frikësuar dhe të çoroditur dhe shanset tona të jenë të pakta, do të jetë e lehtë të ngrijmë në apati.

Rreziqet që na kanosen janë kaq të përhapura dhe megjithatë kaq të vështira për tu vënë re-dhe të dhimbshme për tu parë, kur arrijmë ti shikojmë- saqë të gjithë jemi zhytur në apati.



Asnjëri prej nesh nuk përjashtohet nga kjo. Të gjithë kanë dyshime për rëndësinë e situatës dhe për mundësinë tonë për ta ndryshuar. Pavarësisht nga kjo, nga të gjitha rreziqet që na kanosen, nga ndryshimi i klimës deri në luftërat atomike, rreziku më i madh na vjen nga mos-veprimi.

Indiferenca ka pushtuar mendjen dhe zemrën tonë. E heqim mendjen duke u argëtuar, luftuar me njeri-tjetrin, bredhur dyqaneve dhe duke u marrë me gjëra të tjera. Prandaj duhet ta shikojmë realitetin në sy. Të kuptojmë se çfarë po ndodh me ne. Kjo do të na ndihmojë të zgjohemi nga gjumi dhe ti rikthehemi jetës (siç përshkruhet në librin “Ringjallja). Të ndërjegjësojmë për dëshirat tona më të thella do të jemi në gjendje të përfshihemi në transformimin e madh. Do të zgjedhim jetën.

” – Joanna Macy

Probleme të drejtimit dhe organizimit

Drejtuesit, inicjuesit, mbledhësit ...

Drejtimi është një koncept i gjerë dhe interesant.

Si e përshkruan Chomsky:

"Nëse drejtimi delegohet, monitorohet, drejtuesi zëvendësohet apo largohet nga detyra, atëherë është një pozicion i dobishëm dhe i nevojshëm. Por gjithmonë duhet parë me një sy kritik." (letër 11 Shtator 2007)



Megjithatë fjala “lider” ka kaq shumë kuptime saqë diskutimi i subjektit shpesh shoqërohet me keqkuptime dhe konflikt.

Prandaj ka rëndësi ta përcaktojmë qartë termin.

Në një grup që funksionon mirë, çdo anëtar mund të bëhet drejtues për njëfarë kohe.

Të drejtosh do të thotë të frymëzosh të tjerët, të marrësh iniciativën dhe të orientosh grupin në rrugën që ka zgjedhur.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Kjo zakonisht përfshin role si: analist, ideues, paqëtues, organizues, integruer, përfaqësues i grupit. Të drejtosh nuk do të thotë patjetër të kesh pushtet mbi grupin, por do të thotë ta bësh grupin të ndjehet i fuqishëm. Nuk ka lidhje me hierarkinë, me menaxhimin, “kush është bos” apo me “ndjekësit”. Dhe në veçanti nuk është një cilësi e vazhdueshme e personit.

Çdokush prej nesh mund të bëjë liderin dhe duhet ti zhvillojmë cilësitë e liderit që kemi brenda vetes– të inspirojmë të tjerët dhe të jemi inovativë.

Por duhet të dimë, se në varësi të çfarë duam të arrijmë duhet të mësojmë të bëjmë të gjitha rolet: nxitësin, punëtorin, kohëmatësin, koordinuesin, mbështetësin, procesverbal-mbajtësin, shpikësin, kontribuesin etj. Nëse dëshirojmë të jemi fleksibël dhe të japim maksimumin duhet zhvillojmë cilësitë e nevojshme për të qenë të gjithanshëm.

Por, në grupin tuaj ndoshta nuk ka nevojë për drejtues.

Për sa i përket arritjes së konsensusit, ky është mirë të arrihet nëse koha premtan. Besoj se problemet duhen zgjidhur me pragmatizëm. Prandaj, kur merret një vendim, mendimi i gjithsecilit duhet të dëgjohet, të shikohet me sy kritik por konstruktiv. Si rezultat anëtarët e grupit që mendojnë ndryshe:

- ose ndryshojnë mendim (pa u turpëruar)
- ose pranojnë që të aprovohet idea e tyre e ndryshuar
- ose pranojnë vendimin e marrë nga shumica dhe mendimi i pakicës shënohet në procesverbal.

Sheshimi i konflikteve dhe diferencave gjatë marrjes së vendimeve përmirëson cilësinë e tyre dhe zbatimin e vendimeve nga anëtarët.

Koha

"Jemi të gjithë të varur nga koha" - William Sheikspir

Marrja e vendimeve dhe fillimi i transformimit është emergjent. Kaosi nga ndryshimi i klimës dhe pakësimi i naftës nuk na pret ne të arrijmë unanimitet.

Ndoshta grupi juaj ka kohë. Nëse po, atëherë jeni me fat. Kurse grupet tona kanë hasur shumë pengesa në aktivitetet e tyre. Prandaj nuk duhet ti shtojmë pengesat duke dashur të arrijmë unanimitet për çdo gjë.

Roli i qeverisë lokale

Qeveria deri tani, po luan rol mbështetës, dhe kjo parapëlqehet si nga nëpunësit dhe nga aktivistët tanë.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Gjithmonë kemi menduar se qeverisja vendore do të ketë rol të rëndësishëm në iniciativat e tranzicionit në Britaninë e Madhe dhe në Irlandë. Në muajt e fundit ky rol ka ardhur duke u forcuar.

Për habinë tonë, organet vendore kanë qënë shumë të gatshme të mbështesin iniciativat e tranzicionit. Surprizë tjetër për ne ka qënë që shpesh personat e parë të interesuar për lëvizjen kanë qënë nga organet vendore. Kjo është diçka që e mirëpresim gjithmonë.

Shembuj bashkëpunimi me organet vendore:

Totnes

Nëpunës vendorë u mbledhën në një takim në kolegjin Schumacher në Totnes për tu konsultuar mbi implikimet e pikut të naftës dhe ndryshimit të klimës në punën dhe vendimmarrjen e tyre. 23 anëtarë të këshillave bashkiakë dhe komunalë si dhe deputeti i zonës morën pjesë në mbledhje. Ka disa anëtarë këshillash bashkiakë të cilët janë aktivistë të iniciativave të tranzicionit.



Këshilli bashkiak i Totnesit ka mbështetur zyrtarisht iniciativën e tranzicionit.

Lewes

Kemi komunikuar rregullisht me nëpunës të rëndësishëm të këshillit bashkiak të Lewes që nga takimi ynë i parë në janar. Që kur u krijua këshilli i ri bashkiak, në maj, kemi ftuar shpesh nëpunës të bashkisë në takimet tona dhe kemi pasur biseda shoqërore me ta. Një ndër aktivistët tanë u zgjodh anëtar i këshillit bashkiak dhe dy anëtarë të tjerë të këshillit bashkiak janë mbështetës aktivë të lëvizjes.

Objektivi ynë është të mbështesim këshillin për strategjinë e tij mbi ndryshimin e klimës dhe të sigurojmë mbështetjen e tij në adresimin e pikut të naftës. Gjithashtu planifikojmë tu bëjmë një prezantim mbi lëvizjen e tranzicionit nëpunësve të lartë të organit vendor.

Stroud

I gjithë kabineti i këshillit bashkiak të Stroud-it u takua me Richard Heinberg në maj 2007. Riçardi është autori i 3 librave të rëndësishëm mbi pikun e naftës dhe një ndër oratorët botërorë mbi këtë temë.

Penwith

Këshilli bashkiak i Penwith është partner strategjik i shoqatës së tranzicionit në Penwith që me krijimin e saj në Nëntor 2006. Këshilli ndihmon shoqatën me ambiente mbledhjesh, pajisje, asistencë

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

në marketing dhe zhvillim, me këshilla mbi financimin dhe gjetjen e partnerëve. Nëpunësi i këshillit bashkiak për zhvillimin e qendrueshëm është anëtar i komitetit të shoqatës së tranzicionit dhe financieri i saj.

Nëpunësit e këshillit po ndihmojnë në shumë mënyra. Psh. nëpunësi i këshillit për turizmin e qendrueshëm po bashkëpunon me shoqatën e tranzicionit për krijimin e një modeli turizmi për gadishujt e Europës. Nëpunësi i këshillit përgjegjës për bujqësinë po bashkëpunon me shoqatën e tranzicionit për financimin dhe ri-krijimin e tregut fshatar në qendrën e qytetit dhe për të bërë një projekt bujqësie urbane.

Shoqata e tranzicionit në Penwith bashkëpunon me anëtarët e këshillave komunalë, bashkiakë të rrethit të Penwithit. Shoqata mbështetet nga deputeti i zonës, S. Andrew George, i cili ka mbajtur fjalime në takimet e shoqatës dhe ka bërë pyetje në parlament të cilat i janë sugjeruar nga shoqata.

Kryetarë të bashkivetë Penzance, Shën Ives dhe Shën Just kanë marrë pjesë në aktivitete të shoqatës së tranzicionit dhe kanë shprehur mbështetjen e tyre.

Raste të komunikimeve më anëtarët e këshillave dhe me kryetarët e bashkive

Më poshtë ju citojmë umeile dhe komunikime me anëtarët e lëvizjes së tranzicionit:

- **Anëtar i këshillit bashkiak:** "Jam anëtar i këshillit bashkiak në këshillin xxxx dhe kam ndjekur me interes të madh aktivitetet tuaja... Po kërkoj dokumenta që përshkruajnë me pak fjalë objektivat e lëvizjes suaj me qëllim që tua shpërndaj dhe kolegëve të mi. A mund të më ndihmoni në sigurimin e këtyre dokumentave?"
- **Kryetari i bashkisë:** "Emri im është xxxx, kryetar i bashkisë xxxx në Warwickshire. Jam shumë i interesuar të filloj disa projekte vendore ambjentaliste në vitin e parë të detyrës sime. Si fillim planifikoj të organizoj një aktivitet në vjeshtë. Jam i interesuar të bashkëpunoj me juve dhe një ndër aktivistët tuaj të mbajë fjalim në aktivitet"
- **Anëtar i këshillit bashkiak:** "Jam aktivizuar me një grup i cili po krijon një shoqatë tranzicioni në qytetin, Manchester, dhe shpresojmë që projekti të nxisë krijimin e shoqatave të tjera të ngjashme."
- **Kryetari i këshillit bashkiak:** "Jam kryetar i këshillit bashkiak xxxx, prej 6 vitesh. Kam propozuar që grupi i planifikimit urban të marrë në konsideratë problemet e ngritura nga lëvizja e tranzicionit. Libri juaj "Alfabeti i..." ka shumë informacion dhe pres me padurim të vizitohet Totnes-in."



Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- **Kryetari i këshillit bashkiak** (në postën zanore): "Së fundmi fituam zgjedhjet për këshillin bashkiak, në manifestin tonë përfshimë lëvizjen e tranzicionit dhe dëshirojmë të kontaktojmë me ju për tu informuar si mund të mbështesim komunitetin në krijimin e një shoqate tranzicioni."
- **Nëpunës i lagjes Parish Plans**: "Lagja Parish Plans ka në objektivin e saj zhvillimin e qendrushëm dhe ambientalist, natyrshëm hapi tjetër është krijimi i një Plani Aksioni për Pakësimin e Energjisë. "

Rekomandime mbi përfshirjen e organeve vendore

Rekomandimet e mëposhtme janë bërë nga nëpunësit e organeve vendore aktivë në lëvizjen e tranzicionit apo pjesëmarrës në diskutime të tranzicionit. Roli më i mirë që qeverisja mund të luajë duket të jetë **mbështetja e lëvizjes, jo drejtimi i saj.**

- Kryetari i këshillit bashkiak: "Megjithëse këshilli bashkiak duhet të mbështesë lëvizjen e tranzicionit, mendoj se lëvizja duhet të mbetet e udhëhequr nga komuniteti. Modeli më i mirë është që iniciativat duhet të vijnë nga poshtë dhe të mbështeten dhe inkurajohen nga lart.

Si nëpunës duhet ta kemi të qartë se tranzicioni nuk do të imponohet, është diçka që do të ndodhë natyrshëm. Por këshilli do të ndihmojë në lindjen e tranzicionit, në përhapjen e ideve të tij në pjesë të tjera të komunitetit."

- anëtar i këshillit komunal (themelues i shoqatës së tranzicionit për Penwith): "Besoj fort se iniciativat e tranzicionit duhet të përfshijnë qeverisjen vendore në të gjitha aktivitetet e tyre dhe se ato duhet të influencojë dhe qeverisjen qendrore. Ka rëndësi që iniciativat të mos marrin karakter politik dhe të mos drejtohen nga këshilli bashkiak, por ato duhet të mbështeten dhe informohen nga këshilli bashkiak. Mos harroni se qëllimi i qeverisjes vendore është mbështetja e komunitetit dhe nëpunësit e qeverisjes vendore punojnë dhe jetojnë në komunitetin që drejtojnë. Duhet të kapërcejmë mentalitetin "ata dhe ne" dhe të kuptojmë se duhet të bashkëpunojmë për të pasur sukses."
- Anëtar i këshillit bashkiak : "Le të dalin idetë nga komuniteti dhe të zbatohen po prej tij. Detyra e organit vendor është të ndihmojë, dëgjojë, japë këshilla, kontakte ose fonde, por ç'ka ka më shumë rëndësi, të sigurojë që burokracia nuk bëhet pengesë e iniciativës."

Mënyra e bashkëpunimit do të përmirësohet me kohën. Për momentin, kufizimi i qeverisjes vetëm në mbështetje po funksionon mirë.

Përfshirja e bizneseve

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Bizneset kanë interes të funksionojnë mbi parimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky parim po bëhet gjithmonë e më shumë pjesë e mendësisë së biznesit. Theksimi i **CSR** dhe përdorimi i kontabilitetit të trefishtë mund të jenë hapat duhur. Tregëtia e karbonit mund të ndihmojë në ulje të ndjeshme në nivelin e emetimeve CO₂. Por asnjë nga këto nuk ndihmon bizneset që fabrikojnë me pjesë këmbimi të siguruara në anë të ndryshme të botës, apo që u shërbejnë tregjeve të largëta.




Bizneset që duan të funksionojnë për një kohë të gjatë dhe që e kuptojnë efektin e pikut të naftës në ekonomi, duhet të shqyrtojnë konsumin e energjisë në të gjitha aktivitetet e tyre dhe në 4 fusha specifike: materialet e para, përpunimi i mbeturinave, energjia dhe tregu.

Shembuj nga Totnes

Nga Totnes mund të sjellim shumë shembuj. Ndër to përmendim **auditimin e bizneseve për ndikimin e tyre nga çmimet e naftës**, shkëmbimet mes bizneseve dhe monedha lokale:

Auditimi i bizneseve për ndikimin e tyre nga cmimet e naftës analizon në detaje ndikimin e rritjes së çmimeve të naftës ndaj bizneseve: analizon kostot, lëndët e para, energjinë e shpenzuar për proceset kryesore dhe kostot e transportit për të shitur dhe reklamuar mallin. Pasi është ndërtuar modeli i kostove, parashikohen skenarët me çmime të ndryshme naftë. Skenarët tregojnë se rritja e lartë e çmimeve të energjisë falimenton aktivitete të caktuara të bizneseve. Për këto raste ndërtohen plane të shpëtimit të biznesit, si psh. gjetja e lëndëve të para alternative që ndodhen më afër vendit të prodhimit, tregëtimi në vende që do të ndikohen më pak nga rritja e kostove të transportit.

Shkëmbimet mes bizneseve janë skema për riciklimin e mbetjeve. Skema përpiqet të çiftojë biznese ku mbeturinat e njërit biznes janë lëndë e parë për biznesin tjetër. Psh. biznesi i ndërtimit prodhon mbeturina të shumta druri, të cilat mund të përdoren nga kompanitë që përdorin drurin si lëndë e parë për të prodhuar modelet më të fundit të bojlerëve.



Një mënyrë veçanërisht e suksesshme për rritjen e pavarësisë së bizneseve nga energjia është përdorimi i **një monedhe lokale përveç asaj kombëtare**. Qyteti Totnes është duke eksperimentuar me monedhën lokale dhe ka printuar për herë të dytë rreth 10,000 paund Totnes, nga të cilat 2000 do të shiten në javët në vijim. Monedha lokale forcon ekonominë lokale duke shmangur sindromën e kovës së shpuar, kalimin e pasurisë së krijuar nga një komunitet në popullsinë më të gjerë.

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Deri tani, 50 biznese lokale kanë pranuar paundin lokal si mjet pagese.

Lëvizja e Tranzicionit parashikon një të ardhme më të lokalizuar, ku prodhimi dhe konsumi ndodhin më afër shtëpisë. Ku lëndët e para dhe pjesët e këmbimit çmimi i të cilave ndikohet nga rritja e çmimit të naftës shtrenjtohen kaq shumë sa që zëvendësohen me materiale të siguruara lokalisht. Kështu sasia totale e energjisë e konsumuar nga biznesi pakësohet shumë në krahasim me nivelet aktuale.

Ky është vetëm fillimi. Me kalimin e kohës do të zbulohen gjëra të reja. Bashkëpunimi me biznesin ka shumë rëndësi për suksesin e lëvizjes.

Filma mbi pikun e naftës dhe ndryshimin e klimës

Filmat janë shumë të dobishëm për përhapjen e informacionit. Por duhet pasur kujdes me to, sepse mund të krijojnë një ndjenjë dëshpërimi tek shikuesit dhe të pakësojë dëshirën e tyre për të vepruar.

Ka tre lloje filmash:

- ato që shpjegojnë problemin (si psh. "Fundi i rrethinave")
- frymëzojnë për aksion (si psh "Pushteti i Komunitetit") – nga këto ka pak, megjithëse kemi një film "Tranzicioni-Filmi" që po bëhet gjatë 2007.
- ambientaliste: që duan të forcojnë lidhjen tonë me gjallesat e tjera.



Filmat për ri-kthimin e njeriut në natyrë



Ky lloj filmi shikohet më mirë në shtëpi në një rreth të ngushtë shokësh. Këto filma janë më të shtrenjtë se të tjerët.

Filmat përpiqen të shpjegojnë me qetësi ndërveprimin dhe ndërvartësinë e të gjitha formave të jetës mbi tokë me njëra tjetrën dhe me tokën. Ato kritikojnë mentalitetin antropocentrik. Kur shikon një merimangë që thur rrjetën e saj nën ujë, e mbush me ajër, dhe kur insekti bie pre e rrjetës e konsumon atë, në krahasim me këtë arritjet teknologjike të njeriut duken të rëndomta.

(MicroKozmos, shpërndarë nga Pathe në Britaninë e Madhe)

Filma ambientalistë të tjerë:

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- Microkozmos (shikohet më mirë pa audio)
- Baraka
- Koyaanisqatsi
- Migrimi i zogjve (jua rekomandon Rob Hopkins)
- Princesha Mononoke

Filmat-piku i naftës, ndryshimi i klimës, ekonomia, zgjidhjet

Që shikimi i filmit të mos kufizohet vetëm në parjen e tij:

1. Mbani një fjalim hyrës përpara transmetimit duke bërë lidhjen e parashikimeve të filmit me komunitetin tuaj
2. Ftoni pjesëmarrësit të prezantohen me njëri tjetrin dhe të shpjegojnë se përse marrin pjesë në takim.
3. Transmetoni filmin
4. Ndajini pjesëmarrësit në çifte (mundësisht me persona që nuk i njohin) dhe secili do ti përshkruajë palës tjetër për të themi 3 minuta përshtypjet e veta mbi filmin.

Juve mund të jepni udhëzime si psh.: “Çfarë ju shqetëson dhe çfarë ju jep shpresa nga ato që patë”.

5. Bëni pyetje-përgjigje mbi temën e filmit. Sigurohuni të keni një ekspert të fushës, gjithsesi nëse nuk keni ekspert mjafton të përgjigjeni “Nuk e di, por mund të kontrolloj dhe t’ju informoj”
6. Kini kujdes për pyetjet që tregojnë dëshpërim mund të ngjallin frikë në dhomë. Në këto raste mund të tregoheni mirëkuptues për frikën që shfaq personi dhe të pyesni pjesëmarrësit: “ka të tjerë që po ashtu kanë frikë, nëse po të ngrenë dorën”

Ngrini dorën tuaj dhe prisni. Do të shihni shumë veta të ngrenë dorën, në rast të kundërt pjesëmarrësit gënjejnë veten se nuk kanë frikë.

Mund tu shpjegoni se lëvizja e tranzicionit ka grupe ku njëri mund të marrin konsulta psikoterapike (ky është zakonisht grupi i “Zemrës dhe mendjes”)

Filmat e rekomanduar:

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Titulli dhe detajet	Komente mbi filmin	Shkalla e pesimizmit/shkalla e dhënies së zgjidhjeve	Ku mund të sigurohet	Kostot e prodhimit/monedha
<p>“Fundi i rrethinave: Pakësimi i naftës dhe kolapsi i ëndërrës amerikane”</p> <p>2004</p> <p>78 minuta</p> <p>Kanda</p>	<p>http://transitionculture.org/?p=146</p> <p>o Ky film është interesant sepse i thotë gjërat pa dorashka, tregon se si do të mbetemi pa naftë, pa infrastrukturë transporti, pa ekonomi globale, pa asgjë, me përjashtim të lokalizimit.</p> <p>Është evidente apo jo? Apo më duket vetëm mua? Filmi shpjegon çdo gjë shumë qartë. Transmetimi i tij i frymëzon njerëzit të veprojnë.</p>	E lartë/e ulët	<p>www.powerswitch.org.uk/order.htm</p> <p>Sipas sitit të filmit: Mund ta transmetoni filmin sa herë të doni, kujt të doni, pa fitim për sa kohë DVD është origjinale. Lejohet mbledhja e pagesave modeste për shikimin e filmit, që shërbejnë për mbulimin e kostove apo krijimin e fondeve për OJF-të.</p> <p>www.endofsuburbia.com/previews.htmUS</p>	E lartë/USD
<p>Piku i Naftës: E kërkon natyra</p> <p>2005</p> <p>30 minuta</p> <p>Norvegji.</p>	<p>Në Internet</p> <p>o Kjo DVD të trondit – shikuesi kupton sesa do të ndryshojë stili ynë i jetesës. Jeta jonë konsumiste do të jetë përrallë e së kaluarës pas 50 vitesh.</p> <p>o Ka shumë argumente konkrete të vështira për tu kundërshtuar. Nëse piku i naftës është fenomen që do të ndodhë, atëherë stili ynë i jetesës-nga makinat deri tek supermarketet-do të ndryshojë shumë. Çdokush, me përjashtim të miliarderëve, do të duhet të bëjë sakrificat të mëdha.</p> <p>o Në film intervistohen shkencëtarë të dëgjuar nga e gjithë bota, por kryesisht nga Europa.</p>	E lartë/e ulët	<p>www.powerswitch.org.uk/order/htm</p> <p>Sipas sitit : Mund ta transmetoni filmin sa herë të doni, kujt të doni, pa fitim për sa kohë DVD është origjinale. Lejohet mbledhja e pagesave modeste për shikimin e filmit, që shërbejnë për mbulimin e kostove apo krijimin e fondeve për OJF.</p> <p>www.powerswitch.org.uk/order.htm</p>	Mesatare/eur o
<p>Pushteti i komunitetit: Si Kuba mbijetoi pikun e naftës</p> <p>2006</p>	<p>http://transitionculture.org/2006/04/28/transition-culture-presents-the-uk-premiere-of-the-power-of-community/#more-315</p> <p>oËshtë film shumë i bukur, jua rekomandojmë .</p>	E lartë/e ulët	<p>www.powerswitch.org.uk/order.htm</p> <p>Sipas sitit të filmit: "të gjitha transmetimet publike duhet të jenë jo-komerciale, por mund të mbledhni tarifa të ulëta për të mbuluar kostot e transmetimit se për të mbledhur fonde për</p>	Mesatare/në te dy monedhat

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

53 minuta SHBA	o Premiera e filmit ka pasur shumë sukses në SHBA dhe në Irlandë		OJF.” www.powerofcommunity.org/	
Impakti i fortë 2006 97 minuta SHBA	http://transitionculture.org/2006/12/12/review-new-peak-oil-film-crude-impact/#more-550 o me shumë pasion dhe qartësi prezanton argumentin se jemi në ose afër pikut të naftës, një tranzicion historik. o është pak i gjatë. Mbi 90 minuta.Me raste u përgjuma gjatë shikimit të tij. o Pak flet për jetën pa naftë. Filmi flet jo vetëm për vartësinë tonë nga nafta, por dhe për gjithçka që është bërë për të vazhduar me konsumin e lartë në naftës. Filmi ndërgjegjëson se ka ardhur koha të ndërpresim këtë vartësi.	Mesatare/e ulët	www.powerswitch.org.uk/order.htm Prodhuesi i filmit kërkon 115 dollarë për transmetimin e filmit nga OJF në publik me audiencë më të vogël se 50 persona, plus koston e DVD. Personat e tjerë duhet të kontaktojnë screenings@vistaclarafilms.com www.crudeimpact.com/page.asp?content_id=9587	E lartë/USD
Zgjimi i beftë: Depresioni i madh i naftës 2006 85 minuta Zvicër	http://transitionculture.org/2007/02/07/film-review-a-crude-awakening-the-oil-crash/#more-586 o shumë mbresëlënëse, përshkrimi më i mirë në film i fenomenit të pikut të naftës o Filmi flet vetëm për pikun e naftës, ai jep një përshkrim të shkurtër,të argumentuar, të qartë se çfarë është piku i naftës dhe çfarë implikimesh do të ketë ai për njerëzimin. o Filmi përpiqet mos të jetë sensacional, i lë faktet të flasin vetë. Nuk është shumë eksplisit për impaktin që do të ketë piku i naftës, duke e lënë shikuesin të nxjerrë vetë konkluzionet.	Mesatare/e ulët	Nuk ka dalë ende në shitje. Për të rejat e fundit mbi të lexoni: www.oilcrashmovie.com/dvd.html Azhornim 23 Korrik 2007: Shpërndarësi i filmit në Britaninë e Madhe është Dogwoof Pictures. Në kinema do të fillojë të transmetohet në 9 Nëntor. Do të përpiqemi që aktivistët e tranzicionit të jenë në premierë. Gjithashtu shikoni në: www.youtube.com/watch?v=Or-TyPACK-g	E lartë/në te dy monedhat
E vërteta e pakëndshme 2006	http://transitionculture.org/2006/11/17/a-review-of-an-inconvenient-truth/#more-530	E lartë/e ulët	Përditësim, nëntor 2007: Për të transmetuar filmin duhet të bëheni anëtar i Filmbank, duke depozituar 150 paund. Marrja me qira e tij, goftë dhe për transmetim nga OJF, kushton 75	E lartë/në te dy monedhat

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

<p>100 minuta</p> <p>SHBA</p>	<p>o filmi përshkruan temën e ndryshimit të klimës me fjalë të thjeshta për jo profesionistët. Ai është tërheqës, me ritëm, me montazh të mirë, e shikova me një frymë. Filmi është imponues, dhe shpresojmë të arrijë qëllimin e tij të mobilizimit të botës në aksion.</p> <p>o Në film nuk flitet për pikun e naftës (megjithëse autori ka folur shpesh për të pas realizimit të filmit), fenomen i cili ka efekt të thellë në disa nga zgjidhjet e propozuara nga autori për ndryshimin e klimës. Autori nuk i jep rëndësi rolit që kapitalizmi global ka pasur në ndryshimin e klimës. Ndër zgjidhjet që ofrohen duket sikur dritat fluoreshente do të shpëtojnë planetin, apo që biodiezeli do të mjaftojë për të gjithë makinat. Pra me pak fjalë që jeta mund të vazhdojë si zakonisht me pak ndryshime të sipërfaqshme.</p> <p>o Al Gore e prezanton problemin qartë, prek pikat kryesore dhe e mbyll filmin me mesazhin se ka kohë për të shmangur skenarin më të keq. Këtë e bën me shumë elegancë, gjatë gjithë filmit.</p>		<p>paund, plus 15 paund për dërgimin me postë dhe paketimin. Filmbank mund të kontaktohet në numrine telefonit: 020 7984 5957/5958, www.filmbank.co.uk</p> <p>Megjithatë, po diskutojmë me Paramount që ta transmetojmë filmin pa pagesë. Në 7 Maj filmi do të transmetohet në fshatin Wolvercote ndaj 75 pjesëmarrësve, falas, me lejen e Paramount. www.climatecrisis.net/trailer/</p>	
<p>“Arratisja nga rrethinat: përtej ëndrrës amerikane”</p> <p>2007</p> <p>SHBA</p>	<p>Nga siti i filmit</p> <p>o Filmi eksploron stilin amerikan të jetës dhe të ardhmen e tij pas pikut të naftës.</p> <p>o Analizën kritike të filmit nga Rob Hopkins mund ta gjeni në adresën e internetit: http://transitionculture.org/2007/08/17/a-review-of-escape-from-suburbia/</p> <p>o Disa shikues në Britani i kanë gjetur dëshmitë të mërzitshme dhe theksimin e arratisjes në vend të përshtatjes, si jo realiste-ku do të arratisen njerëzit?</p>	<p>Mesatare/e ulët</p>	<p>www.escapefromsuburbia.com OJF-të kanë leje t’jua transmetojnë filmin falas anëtarëve të tyre. www.youtube.com/watch?v=J2y9BbNjLAY US</p>	<p>I lartë/USD</p>
<p>“Energjia në udhëkryq: një nevojë urgjente për të ndërruar rrugë”</p>	<p>Analiza nga Mike Grenville:</p> <p>o Filmi fokusohet në situatën në SHBA, gjithsesi ka</p>	<p>E lartë/e lartë</p>	<p>www.energyxroads.com/buydvd.html</p> <p>Transmetimi i filmit: Versioni i DVD-së për transmetim publik</p>	<p>I lartë/USD</p>

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

<p>2007</p> <p>54 minuta</p> <p>SHBA</p>	<p>relevancë dhe për vendet e tjera, dhe është optimist për zgjidhjen e problemit.</p> <p>Në sitin e filmit thuhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Me rritjen e popullsisë globale dhe të konsumit të energjisë, shterimi i burimeve natyrore dhe ndryshimi i klimës janë bërë probleme akute. o Shumica e ekspertëve bien dakort se piku i naftës do të ndodhë në 15 vitet që vijnë dhe do të ndryshojë në mënyrë drastike botën e industrializuar. o Që të mbijetojmë pasojat e stilit modern vetëshkattërrues të jetesës duhet të ndryshojmë radikalisht mënyrën e jetesës dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. o Ekspertët mendojnë se energjia alternative si energjia djellore dhe ajo e erës, kursimi i energjisë, eficientia më e lartë energjitike, do të jenë ndryshimet kryesore të nevojshme për ruajtjen e cilësisë së jetesës dhe për një zhvillim të qëndrueshëm. 		<p>kushton 59.95 dollarë jep të drejtën e transmetimit të DVD-së jo në kinema, sa herë dëshironi, nëse nuk kërkon pagesë. DVD ka dhe 1 orë shtesë regjistrim, përfshirë një dokumentar 25 minutësh i prodhuar në vitin 1974 pas embargos së naftës të vitit 1973, me intervistime etj.</p> <p>www.energyxroads.com/trailer.html US</p>	
<p>Paraja si borxh</p> <p>2006</p> <p>47 minuta</p> <p>Kanada</p>	<p>Në sitin www.themoneymasters.com thuhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> o Filmi i shkëlqyer, zbatimës, vizatimor i autorit, animues dhe kameraman, Paul Grignon, shpjegon, me detaje, sistemin monetar të sotëm në mbrapshtësinë e vet. <p>Sipas Ben Brangwyn të rrjetit të tranzicionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> o E rekomandoj për të gjithë. Shpjegon, thjesht dhe qartë, funksionimin e bankave që nga ditët e hershme e deri më sot. Sipas filmit, pa një reformë monetare në sistemin e kredive/interesave bankare nuk mund të ketë një zhvillim të qëndrueshëm. o Filmi nxit krijimin e monedhave lokale o anëtarët e grupit të punës për ekonominë mund ti zgjidhni nga entuziastët e këtij filmi 	<p>E lartë/e lartë</p>	<p>http://www.moneyasdebt.net/ Nga prodhuesi rekomandohet të blihet me shumicë nga 10 copë, me të drejtën e transmetimit. Të transmetohet falas dhe të interesuarve për ta blerë tu shitet.</p> <p>Komenti i Benit: paketa me 10 DVD kushton 55 paund. Nëse arrini të shisni 6, me çmim 10 paund copa, keni nxjerrë shpenzimet e blerjes. Besoj 1 në 12 shikues do kërkojnë ta blejnë.</p> <p>http://www.moneyasdebt.net/ click Trailer</p>	<p>Ok. Ka vizatime të thjeshta me audio të shkëlqyer</p>
<p>Ora e 11-të (prodhuar nga</p>	<p>Komente të një kolegu mbi filmin:</p>	<p>E lartë/e lartë</p>	<p>Për momentin po shfaqet në kinema. Për të</p>	<p>Shumë e</p>

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

<p>Leonardo DiCaprio)</p> <p>2007</p> <p>SHBA</p>	<p>o në filëm ekspertët janë protagonistët, Leonardo pak merr pjesë në të.</p> <p>o tema e filmit nuk kufizohet vetëm në pikun e naftës dhe ndryshimin e klimës por përfshin temën më të gjerë të zhvillimit të qendrueshëm</p> <p>o është shumë kritik ndaj korporatave dhe qeverisë SHBA dhe vë në pikëpyetje konceptin e rritjes ekonomike të vazhdueshme.</p> <p>o është filozofik, por i thjeshtë për tu kuptuar</p> <p>o konkluzionet e tij janë optimiste. Filmi fillon me nota shumë depresuese, por nga fundi bëhet optimist dhe shpresëdhënës.</p> <p>Pikët e dobëta të filmit:</p> <p>o shumë amerikan</p> <p>o aspekti “çfarë mund të bëni personalisht” nuk trajtohet mirë.</p>		<p>drejtat e transmetimit jemi në pritje.</p> <p>http://wip.warnerbros.com/11thhour/</p>	<p>lartë/ me interes për të gjithë</p>
<p>Ngrohja Globale</p> <p>2006</p> <p>Kanada</p>	<p>Mbështetur nga Federata Kombëtare e Kafshëve të Egra, SHBA</p> <p>Analiza nga Ben Brangwyn, Britani e Madhe</p> <p>Anët pozitive:</p> <p>o trajton efektin në ngrohjen globale të cikleve fid back, si psh. avujve të ujit-ky fenomen shpesh nënvleftësohet</p> <p>o ka tregime nga shumë persona, nuk prezantohet materiali nga një person i vetëm, zakonisht politikan i nivelit të lartë.</p> <p>o përfshin të gjitha efektet e mundshme të ngrohjes, si psh. bujqësia, nivelet e detërave, thatësi, madje dhe mbi lumin Tamiz- kjo e fundit e frikshme nëse punoni si deputet në parlament</p> <p>o Nuk analizon efektet në Amerikën e Veriut</p>	<p>E lartë/mesatare</p>	<p>https://www.thegreatwarming.com/orderform.php, janë kërkuar informacione nga siti në lidhje me liçencimin</p> <p>http://www.thegreatwarming.com/</p>	<p>Shumë e lartë/me interes për të gjithë</p>

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

	<p>Anët negative:</p> <p>o mbivlerëson novacionet teknologjike si zgjidhje si psh. prodhimin e energjisë nga hidrogjeni, “pemët” e bëra nga njeriu për të fiksuar karbonin e atmosferës o nënvlerëson nevojën e ndryshimit radikal të stilit të jetesës</p>			
<p>Çfarë jete: fundi i perandorisë</p> <p>2007</p> <p>123 minuta</p> <p>Kanada</p>	<p>Sipas Ben Brangwyn: Të mirat e filmit:</p> <p>o i ashpër, udhëtim personal dramatik në shkatërrimin ekologjik modern. Nëse nuk jeni të përgatitur dhe s’keni lexuar më parë Derrick Jensen, ose Ran Prieur, apo parë filmin "Vdekja e rrethinave" mund të tronditeni nga filmi. Nëse i keni lexuar autorët e sipërpërmendur, ju rekomandojmë ta shikoni filmin.</p> <p>o tematikën e ka mjaft të gjerë – diskuton konvergencën e pikut të naftës, ndryshimit të klimës, pakësimit të burimeve natyrore dhe rritjes së popullsisë.</p> <p>Të metat: o nuk ofron shumë zgjidhje o nuk ngjall shpresë, prezumon se civilizimi duhet të shembet që ekulibri natyror të rikthehet: nuk besohet se shoqëria mund të transformohet.</p>	E lartë/e ulët	<p>www.whatawaytogomovie.com Transmetimi në publik të kufizuar kushton 50 \$. Paketa me 10 DVD kushton 210 \$, leja për dhënie me qira kushton 197 \$. www.whatawaytogomovie.com/trailers/</p>	Shumë e lartë/me interes për të gjithë
<p>Mesazhi në det</p> <p>2007</p> <p>123 minuta</p> <p>BBC NaturalWorld 2007</p>	<p>Nga Ben Brangwyn në Britaninë e Madhe: Të mirat:</p> <p>o film frymëzues, i bukur, prekës mbi efektin e mbeturinave plastike në gjallesat e oqeanit. Përfshin komente mbi qytete që kanë vendosur të ndalojnë përdorimin e qeseve plastike.</p> <p>Të metat: o ka shumë pamje nga plazhet (megjithëse disave kjo</p>	E lartë/e ulët	<p>http://www.megaupload.com/?d=7HNOTYWA BBC ka dhuruar shumë kopje të DVD-së. Mund ta downloadoni dhe në faqen tonë të internetit. http://www.messageinthewaves.com/</p>	Shumë e lartë/me interes për të gjithë

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

	mund t'ju pëlqejë!) o do ju pështirosë përdorimin e qeseve plastike (ndoshta dhe kjo në fakt duhet parë si e mirë e filmit)			
Peisazhe të fabrikua	Komente nga James Samuel aktivist i tranzicionit në Ishullin Waihek, Zelandë e Re: "Ky film më shokoi me pamjet e tij. Fillon me një tablo të Kinës industriale. Filmi tregon dhe realitetin tjetër, paralel, nga i cili nuk jemi të pavarur. Tregimi nga Edward Burtynsky është konçiz dhe ndërpritet herë pas here-aq sa duhet për të ruajtur linjën e filmit. Flet dhe për pikun e naftës."	E lartë/e ulët	http://www.mongrelmedia.com/films/ManufacturedLandscapes.html Nuk ka leje për transmetimin nga OJF në takime. http://www.youtube.com/watch?v=67j7JIEZzpQ	Shumë e lartë/me interes për të gjithë
2007				
90 minuta				
Kanada				

Rrjeti i Tranzicionit

Kemi krijuar një shoqatë kombëtare të tranzicionit, “Rrjetin e Tranzicionit” për të mbështetur shoqatat më të vogla të tranzicionit që po krijohen në të gjithë Britaninë dhe Irlandën. Misioni i shoqatës, e cila mbështetet me financime nga Fondacioni Tudor dhe fondacioni Esmee Fairbairn, është:

"të frymëzojë, inkurajojë, mbështesë, ndërlihdë dhe trajnojë komunitetet në formimin e shoqatave të tranzicionit sipas modelit të tranzicionit. Modeli i tranzicionit nxit komunitetet të konsiderojnë efektin e pikut të naftës dhe ndryshimit të klimës, të angazhojnë mençurinë e tyre kolektive për transformimin e shoqërisë në përgjigje të pakësimit të energjisë dhe për pakësimin radikal të emetimit të dioksidit të karbonit (si përgjigje ndaj ndryshimit të klimës)."

Po mbledhim materiale, mbajmë kurse trajnimi, takime, po mbledhim fonde dhe po krijojmë infrastrukturën e mbështetjes së këtyre komuniteteve. Jemi në fillimet tona dhe kemi shumë punë përpara por kjo nuk na tremb!

Qendra e shoqatës është në Totnes, më afër qytetit ku po ndodhin ndryshime të mëdha si pasojë e tranzicionit. Vizioni ynë është një Britani e Madhe e fortë përballë sfidës së pikut të naftës dhe një Britani që ka pakësuar ndjeshëm emetimet e dioksidit të karbonit.

Që të keni një ide të përmasave të objektivit tonë, ka rreth 11,000 fshatra dhe qytete në Angli dhe Wells, si dhe 60 qytete të mëdhaja dhe shumë komunitete rurale. Secili prej këtyre komuniteteve do të duhet të pakësojë ndjeshëm konsumin e energjisë. Njerëzimi tregoi inteligjencë të jashtëzakonshme në shfrytëzimin gjithmonë e më të madh të energjisë. Tani me po këtë inteligjencë duhet të përshtatemi për jetën me më pak energji. Dhe në fakt, nëse fillojmë ndryshimin herët, jemi krijuar, gjithpërfshirës, mund të zbulojmë se jeta me më pak energji është më e mirë se jeta aktuale e vetmuar e shumë prej nesh.

Konkluzione



Aktivizimi në të trija nivelet, atë global (si psh. marrëveshja e Kiotos, protokollin e pakësimit të naftës, apo protokollin e kovergjencës dhe turrje), në nivelin kombëtar (psh. tregëtimi nga shtetet e kuotave të karbonit) dhe në nivel lokal (psh. shoqatat e tranzicionit) – premtojnë shumë për transformimin energjetik të civilizimit në shekullin e 21-të. Duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin, kemi



potencialin të krijojmë një botë më kuptimplotë, të barabartë dhe me një zhvillim më të qëndrueshëm.

Sfida qëndron në përballimin e njëkohshëm të dy problemeve të mëdha, pikut të naftës dhe ndryshimit të klimës. Nëse e dëshirojmë apo jo, në të ardhmen do të ketë më pak energji. Më mirë të përgatitemi tani, se të presim të keqen.

Lexime të tjera

Linqet janë të datës 20 Qershor 2007.

Mbi tranzicionin:

- Rob Hopkins “Alternativa të konsumit të pakësuar të energjisë: përgjigjet e mundshme ndaj pikut të naftës”,

Tezë diplome e publikuar nga vetë autori në faqen: www.transitionculture.org/?page_id=508

Mbi pikun e naftës:

- Buletini i Energjisë

o shpjegim i shkëlqyer i pikut të naftës në sitin: www.energybulletin.net/primer.php

o lajme mbi çështje të energjisë: www.energybulletin.net

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

- ASPO – Shoqata për studimin e pikut të naftës. Është burim i mirë të dhënash dhe idesh, shoqata e parë që filloi të ndërgjegjësojë publikun mbi pikun e naftës.

- www.peakoil.net/

- Raporti Hirsch – u përgatit me porosi të qeverisë së SHBA-së në vitin 2005. Doli në vëmendje të opinionit publik në vitin 2006. Është mjaft i qartë në kërkesën e tij për marrjen e masave urgjente për përshtatjen ndaj pikut të naftës:

- www.netl.doe.gov/publications/others/pdf/Oil_Peaking_NETL.pdf

- David Strahan (2007) Shoku i fundit: si të mbijetojë njeriu i naftës nga zhdukja. Publikuar nga John Murray. Ndoshta libri më i mirë mbi pikun e naftës dhe implikimet e tij për Britaninë e Madhe. Për më shumë info shikoni sitin www.davidstrahan.com/. Ka dhe lajme të fundit.

- Librat e Richard Heinberg:

- Argëtimi mbaroi: Nafta, lufta dhe fati i shoqërive të industrializuara

- Energjia iku: alternativa dhe plane veprimi në një botë pas karbonit

- Protokollin e shterimit të naftës : Një plan për shmangjen e luftërave për naftë, shmangjen e terrorizmit dhe kolapsit ekonomik

- Në websitin e Buletinit të Energjisë botohen shpesh artikuj të tij mbi pikun e naftës.

- www.theoil Drum.com. Faqe interneti me grafike, të dhëna dhe analiza komplekse të pikut të naftës. Ka nivel të lartë shkencor.

Faqe mbi ndryshimin e klimës:

- Paneli Ndër-qeveritar mbi Ndryshimin e Klimës- organizata botërore përgjegjëse për analizimin e ndryshimit të klimës. Faqja zyrtare e saj është në:

- www.ipcc.ch

- Artikuj të shkencëtarëve të klimës mbi lajmet më të fundit mbi ndryshimin e klimës

- www.realclimate.org :

- Qendra Hadley – komiteti për kërkimet shkencore mbi efektet potenciale të ndryshimit të klimës. Faqja zyrtare është në

- www.metoffice.gov.uk/research/hadleycentre/

Detaje kontakti:

Abetarja e lëvizjes së tranzicionit

Ben Brangwyn

Bashkë-themelues i “Rrjetit të Tranzicionit”

email: benbrangwyn@transitionnetwork.org

Telefon: +44 5601 531882

skype: benbrangwyn